



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Nr.1102/10 Prot.

Tiranë, më 13/ 5/2016

V E N D I M

Nr. 51, Datë 13/ 05/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME GJIROKASTËR "MBI PROCEDURËN E PRANIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE EVIDENTIMIN E TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, për procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin e trajtimin ligjor të mbivendosjeve*", të ushtruar në ZVRPP Gjirokastrë, për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

Gjetje 1: Nga auditimi në ZVRPP Gjirokastrë lidhur me regjistrimin e trojeve të shtëpive të banimit, ekzistuese para v.1991 të ndodhura në Zonat Urbane Rurale të fshatrave rezulton të jenë regjistruar troje me sipërfaqe tepër në 20 raste me 5056 m². Kjo situatë është konstatuar edhe në disa ZVRPP Korçë, Kavaje, Sarandë, Pogradec etj. Rastet me sipërfaqe tepër kanë rezultuar

referuar normës deri në 300 m², përcaktuar në Dekretin nr. 5747, datë 29.6 1978 ”Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave”, nenit 10 paragrafi 2 ku shprehet *“Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore jepet në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²”. Ky Dekret nuk është shfuqizuar, është ende në fuqi prej vitit 1991 kur ka filluar reforma e tokës dhe hartimi i listave 001 të trojeve të shtëpive të banimit.*

Rekomandim 1: Ministri i Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë të kërkojnë ndryshimin e Dekretit nr. 5747, datë 29.6 1978 ”Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave”, ose të hartojnë me një akt tjetër normues ku të përcaktohet: *“Trualli për efekt regjistrimi për banesë para vitit 1991 Zonat Urbane Rurale të fshatrave të jetë në kufijtë fizik deri në 500 m², duke përfshirë këtu dhe Sipërfaqja e truallit për nevojat plotësuese të një familje bujqësore rurale”* argumentuar si vijon:

Në auditimet e kryera, në regjistrimin e trojeve të shtëpive ekzistuese të banimit para v.1991 në Zonat Urbane Rurale të fshatrave i jemi referuar normës truallit deri në 300 m² përcaktuar në Dekretin nr. 5747, datë 29.6 1978, Dekret tashmë i tejkaluar qysh pas viteve 1990 dhe për faktin sepse ky Dekret nuk është shfuqizuar dhe nuk është hartuar ndonjë akt ligjor a nën ligjor tjetër në zëvendësim të tij .

Referimi në normën e truallit 300 m², ka sjellë si pasojë edhe rekomandimet e KLSH për veçim dhe regjistrim “shtet” apo kufizime të sipërfaqeve tepër e mbi këtë normë. Rekomandimi i diktuar nga zbatimi i Dekretit për sipërfaqen tepër jo vetëm është praktikisht e pamundur për zbatim por mendohet edhe i padrejtë ndaj familjeve të zonave rurale, fshatare, sepse ky referim në kufirin 300 m², në Dekretin e vitit 1978 është i tejkaluar sepse vetë Dekreti i referohet kushteve të ekonomisë së centralizuar për pasojë kjo normë parashikonte vetëm nevojën për banesë duke përjashtuar dhe mos përfshirë nevojat për truall me funksion ndihmës si për ngrehina për mbulim të aktivitetit individual bujqësor mbajtjen e veglave, mjeteve të punës, kafshe pune e prodhimi, shpendë shtëpiak, depozitim prodhimesh bujqësore; nevoja të cilat në kohën e Dekretit mbuloheshin nëpërmjet veprimtarive dhe ambienteve të kolektivizuara si depo, stalla magazina, pulari, SMT etj . Ndërsa pas vitit 1991 këto nevoja (të pa përfshira në normën 300 m² të Dekretit) bëhen domosdoshmëri e familjeve fshatare për zhvillimin e aktivitetit bujqësor e blegtoral shmangien e pasojave sociale në stimulimin e lëvizjes nga zonat rurale në zona urbane, si dhe për mbështetje edhe të zhvillimit bujqësor rural si degë e rëndësishme zhvillimi për vendin tonë

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje 1:a. ZVRPP Gjirokastër para deri në vitet 2012-2015 ka nivel të ulët performance të punës lidhur me:

1. Administrimin dhe numrin e konsiderueshëm të kërkesave dhe praktikave të mbetura në proces e të pa përfunduara prej 5 vitesh deri fund të vitit 2014 evidentohen mbi **3287** praktika në proces . gjendje që ka sjellë të ardhura në vlerën **9,909 mijë lekë** të përfituara nga ZVRPP pa dhënë shërbimin e faturuar, mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Gjirokastër ndaj publikut, mos administrimin në arkiv të dokumentacionit, si dhe mbajtjen nga specialistët për afate të gjata të praktikave të aplikimeve sipas tabelës **“Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces dhe të ardhurat e përfituara shërbim prej para Vitet 2012- 2015”**, në kundërshtim e ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”,

2. ZVRPP Gjirokastër ka pamjaftueshmëri dhe mangësi të bazës nënligjore aktuale e cila nuk siguron rritjen e transparencës në shërbimin ndaj publikut, nuk i përgjigjet forcimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm (SKB) lidhur me integritetin e punonjësve në dhënien e shërbimit, sepse mungon rregullorja e brendshme e Funksionimit të Administratës së ZVRPP Gjirokastër miratuar

nga Kryeregjistruesi dhe Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, ende e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhet përmbledhur e plotësuar, por kjo rregullore nuk ka objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja nuk është e përshtatur me kërkesat e ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,

3. Për pasojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave dhe proceseve lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi, shërbimit të IT dhe sidomos lidhur me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve, cilësinë afatin dhe mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve, si dhe lidhur me vjeljen e opinionit për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces, evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj., pra mungon instalimi i Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (*Trajtuar hollësisht në faqet 163-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 1: ZVRPP Gjirokastër, Regjistruesi të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, evadimin sipas një programi të posaçëm të **3287 praktikave**, kërkesave në proces të pa përfunduara prej 5-10 vitesh deri në vitet 2015, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar në vlerën **9,909** mijë lekë, me pasojë mungesën e transparencës së ZVRPP Gjirokastër ndaj publikut, si dhe të administrohen në arkiv dokumentacioni përkatës, në zbatim të legjislacionit më sipër, sipas tabelës analitike “**Përmbledhëse e Praktikave të papërfunduara në proces dhe të ardhurat e përfituara shërbim prej para Vitet 2012- 2015**”.

Rekomandim 2: ZQRPP dhe ZVRPP Gjirokastër të ndjekin hapat e duhur ligjor për instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të vendosin Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) si dhe të hartojnë, miratojnë e zbatojnë Rregulloren e brendshme të Funksionimit të Administratës së ZVRPP Gjirokastër, si njësi e vetme në territorin vendor, bazuar në organikat dhe organigramën dërguar nga Kryeministri me urdhrat nr. 196, datë 4.8.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Urdhrin nr. 33, datë 2.4.2013 të Kryeministrit”. Në Rregullore të përfshihen, përcaktohen, shkruhen, kushtet e pranimit, testimi fillestar të aftësive profesionale dhe trajnimit në vazhdim të punonjësve në ZVRPP, statusi i të punësuarve, përcaktimi i kryerjes së detyrave, ushtrimi i kompetencave dhe mbajtja e përgjegjësisë për secilin specialist, Regjistrues, zv .Regjistrues juristëve dhe punonjës të tjerë, si dhe detyrimet lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi dhe administrimin e dokumentacionit; si dhe për të gjitha këto procese dhe të punësuar të përcaktohen e vendosen *SMKB (Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm)* masa këto të detyrueshme në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Menjëherë

Gjetje 2: ZVRPP Gjirokastër nuk ka marrë pjesë si palë në gjyq, nuk ka informuar gjendjen aktuale juridike të pasurive, **pra** ka krijuar pamundësinë për qartësimin e Vendimit Gjykatës për VKKP nr.53, **ndërsa me referencën nr. 128**, datë 20.06.2011, urdhrin nr. 110, datë 20.06.2011, (*ndërsa mungon në dosje të referencës akti i dorëzimit të sipërfaqes nga ish pronari “Shtet” ose përfaqësuesi i tij që në këtë rast do të ish komuna Cepo dhe ose DAMT Qarkut Gjirokastër*), ka kryer veprime të parregullta në KPP duke mos pasqyruar veprimet të ndarjes dhe të bashkimit në KPP pa çelur KPP-të përkatëse, ndërsa KPP –të ekzistuese gjenden pa vula dhe pa shënimin e referencës, me ndryshime të bëra vetëm mbi shifrat e sipërfaqeve, veprime në kundërshtim me nenin 21 “*Bashkimet dhe ndarjet e pasurive*” të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” të ndryshuar, me nenin 34 dhe 35 të ligjit nr. 33 datë 21.3 2012 “Për

Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Kreun e VI “Trajtimi i Pasurive të Paluajtshme pas Regjistrimit Fillestar”, pika 5 “Regjistrime të ndryshimeve në KPP”, pika 5.1 “Regjistrime që sjellin ndryshime në Seksionin A, B dhe C të Kartelës”, “Ndarja e pasurisë”, të rregullores nr. 184, datë 18.4.1999 “Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, gjithashtu nga mospjesëmarrja në gjyq dhe mos informimi i gjendjes aktuale juridike të pasurive në gjykatë ka pranuar **e regjistruar ndryshimin e zërit kadastral nga “Pemëtore-Ulli” në zërin kadastral “Kullotë” në sipërfaqen totale prej 178970 m² dhe zërit kadastral nga “Arë” në zërin kadastral “Kullotë” në sipërfaqen totale prej 65000 m² “Arë”, pa kërkuar vlerësimin apo kompetencën nga DAMT e Qarkut, veprim në tejkallim të kompetencave e detyrës dhe në kundërshtim me ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin e strukturave për mbrojtjen dhe administrimin e tokës bujqësore” të ndryshuar me ligjin nr. 10 257, datë 25.3.2010 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, neni 11/1, pika 4,a,b. Gjithashtu dokumentacioni i parregullt, nënshkrimi dhe veprimet në referencën nr. 128, datë 20.06.2011, dhe urdhrin nr. 110, datë 20.06.2011 duke mos përcaktuar 8 pasuritë për ndarje e bashkim, pa relacionin përkatës arsyetues për ndarjet e bashkimit, duke mos mbajtur parasysh gjendjen juridike të pasurisë së ndarë me 7501, gjendjen e saj në KPP në bashkëpronësi jo ligjore, pasuar edhe ndryshimet e zërave kadastral kanë sjellë si pasojë mos pajisjen e qytetarëve të fshatit Çepune me certifikata pronësie sipas AMTP-ve, si dhe mungesën e mos kërkimin e marrjen në dorëzim të dokumentacionit të ndarjes së tokës në Fshatin Çepune, ish Komuna Cepo, vijnë në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 556, datë 23.10.2000 “Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë në zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” (Trajtuar në faqet 4-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Rekomandim 3: ZVRPP Gjyrokastër të marrë masa kufizimi sipas nenit 59, 60 dhe 74 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” për një kohë deri sa të bëjë identifikimin dhe menaxhimin e KPP-ve në terren të pasurive bujqësore të regjistruara në bashkëpronësi të paligjshme të paraqitura nga NJMP dhe pranuar nga ZQRPP, si dhe deri në plotësimin me aktin e dorëzimit të sipërfaqes nga ish pronari “Shtet” ose përfaqësuesi i tij pjesë e dokumentacionit të referencës nr. 128, datë 20.06.2011, të vendoset kufizim mbi pasuritë:

1. Pasuria nr. 187/12, v. 3, f.214 me 100000 m² “Kullotë” në emër Pronar “Shehu”, nga bashkimi pjesor i pasurive:

1. Nga pjesë e nr.187/10,v.3, f.71 për 35000m² “kullotë”(770250-35000) “Kullot”

2. Nga pjesë e nr. 196,v.3, f.72 për 49500m² “arë”(59315-49500) kthyer “Kullot”

3. Nga pjesë e nr.198,v.3,f.74 për 15500m² “arë” (22330-15500) kthyer “Kullot”

Shuma 100000 m² “Kullotë” prej 65000 m², “Arë”

2. pasuria nr.164/12, fv. 3, f.215 me 205000 m² “Kullotë” në emër Pronar “Shehu, nga bashkimi pjesor i pasurive:

1. Nga pjesë e nr.7, v.2,f.179 për 31062 m² “Pemë-Ulli”(204300-31062) kthyer “Kullot

2. Nga pjesë e nr.1, v.2,f.184 për 38183 m² “Pemë-Ulli”(70240-38183) kthyer “Kullot”

3. Nga pjesë e nr.3, v.2,f.185 për 52605 m² “Pemë-Ulli”(52605-52605) kthyer “Kullot”

4. Nga pjesë e nr.4, v.2,f.186 për 57120 m² “Pemë-Ulli”(90970-57120) kthyer “Kullot”

5. Nga pjesë e nr.164/11,v.3,f.50 për 26030 m² “kullot”(58390-26030)

Shuma 205000 m² “Kullotë”,prej 178970 m², “Pemëtore”

Kufizimi te zgjasë në plotësimin me dokumentacionin si: aktin e dorëzimit të pasurisë nga përfaqësuesi i pronarit “shtet”, DAMT Qarkut dhe Ish Komuna Cepo, apo Bashkia Gjyrokastër juridiksion i të cilës aktualisht është, deri në momentin e verifikimit dhe argumentimit që sipërfaqja prej 30,5 ha nuk bën pjesë në fondin e tokës bujqësore të ndarë me AMTP, të cilat administrohen nga K/familjarët e Fshatit Çepune.

Deri datë 30.6.2016

Rekomandim 4: ZVRPP Gjirokastër të kryejë veprimet e rregullta në KPP-të, të njoftojë mbajtësit, tërheqë e shpall të pavlefshme certifikatat e pronësisë lëshuar në formë të parregullt në bashkëpronësi të pa ligjshme pasqyruar sipas veprimeve e shënimeve të parregullta të kryera në rubrikën “Përshkrimi i veçantë” me referencat nr. 026 etj të KPP pasuria nr.7, v.2, fq.179 dhe shënimet e kryera me referencat nr. 0186, nr. 1037 në listën e bashkëpronarëve bashkëlidhur kësaj KPP-je.

Menjëherë

Gjetje 3: ZVRPP Gjirokastër me referencat nr. 0179, datë 29.12.2014, nr. 184, datë 23.3.2015, ka bërë bllokim kërkuar nga AKKP me shënim në Seksionin “E” nën përshkrimin “Shkresa nr. 20581, datë 17.12.2014 për pasuritë si vijon:

a. Pasuria nr. 196,v.3, f.72 për 49500 m² “arë”(59315-49500), kthyer “Kullotë”, në fakt sipërfaqja sipas AKKP nuk rakordon me gjendjen faktike të KPP dhe nuk është njoftuar AKKP për sipërfaqen aktuale të mbetur prej 9815 m²

b. Pasuria nr.198,v. 3, f. 74 për 15500 m² “arë”(22330-15500). kthyer “Kullotë” në fakt sipërfaqja sipas AKKP nuk rakordon me gjendjen faktike të KPP dhe nuk është njoftuar AKKP për sipërfaqen aktuale të mbetur prej 6830 m² dhe Pasuria nr. 201, v.3, f.76 z.k.1369 Çepune 17100 m² “Arë” (Trajtuar në faqet 4-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 5: ZVRPP Gjirokastër, Regjistruesi të njoftojë AKKP Tiranë dhe të raportojë sipërfaqet faktike aktuale sipas KPP-ve për pasuritë nr. 196,v.3, f.72 z.k. 1369 nga 49500 m² “arë”(59315-49500), gjendja faktike prej 9815 m², pasurinë nr. 198,v.3, f.74 z.k.1369 nga 15500m² “arë” (22330-15500), gjendja faktike prej 6830 m², pra 3 pasuri të cilat janë pjesë e listës me 1144 pasuri me sipërfaqe totale prej 23 368, 8 ha për të cilat AKKP (ATP) Tiranë ka kërkuar masat kufizuese dërguar me shkresën nr. 20581, datë 17.12.2014).

Menjëherë

Gjetje 4: ZVRPP Gjirokastër dhe ZQRPP Tiranë kanë pranuar e marrë në dorëzim nga Njësia e Menaxhimit të Projektit (NJMP) **78 Kartela** Pasurie të Paluajtshme (KPP) në 12 zona kadastrale për **12 fshatra**, të përfshira në sistem në vitet 1999,2000,2001, me sipërfaqe **1,334,347 m²** ndarë: **151,335 m² arë, 253,902 m² vresht dhe 929 402 m² pemëtore**, përkatësisht për **1107 Familje bujqësore Bashkëpronare** (ku mungojnë e nuk janë bashkëlidhur listat emërore), për të cilat nuk janë identifikuar e hapur KPP-të përkatëse sipas sipërfaqeve përcaktuar në AMTP-të **që ka sjellë si pasojë lindjen e bashkëpronësisë së pa ligjshme**, pamundësinë e lëshimit të certifikatave të pronësisë qytetarëve kërkuar me **cenim të së drejtës së pronësisë çuarjen e zgjidhjes së problemit nëpër gjykata, në vend të zgjidhjes në rrugë administrative nëpërmjet ZVRPP, ZQRPP dhe DAMT-ve të NJQV-ve**; rritjen e praktikave në proces, veprime të paligjshme në KPP, si dhe pamundësinë e mos konfirmimit të gjendjes juridike të pasurive të kërkuara, mos shkëmbimin e informacionit nga ZVRPP për KVVTP Prefektit Qarkut Gjirokastër për të gjitha kërkesat e drejtuara në vitet 2012-2015 nga KVVTP, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim **me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar me ligjin nr. 33/2012 datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)” dhe më vonë ndryshuar me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi”, me rregulloren nr. 184, datë 08.4.1999 “Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, me ndryshimet, Kreu IV, pika 1, ndërsa në secilën AMTP-ve të fermerëve posedues të titujve të pronësisë është përcaktuar sipërfaqja në m², për secilin zë kadastral pasqyruar në tabelën “PASURITË BUJQËSORE NË BASHKËPRONËSI PËR DISA ZONA KADASTRALE” (Trajtuar në faqet 27-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Rekomandim 6: ZVRPP Gjirokastër dhe ZQRPP Tiranë të marrin masat për eliminimin e bashkëpronësisë së paligjshme në **78 Kartela** Pasurie të Paluajtshme (KPP) në 12 zona kadastrale për **12 fshatra**, të përfshira në sistem në vitet 1999,2000,2001, me sipërfaqe me **1,357,447 m²** ndarë: **151,335 m² arë, 253,902 m² vresht dhe 952,260 m² pemëtore** përkatësisht për **1107 Familje bujqësore Bashkëpronare, të kryeje menaxhimin e 12 zonave Kadastrale** të identifikojë e çelë 1107 KPP-të në përputhje me AMTP dhe listat përkatëse si dhe të rekomandojë e zbatojë rrugën administrative të zgjidhjes së bashkëpronësisë në bashkëpunim me DAMT e NJQV pasqyruar në tabelën “PASURITË BUJQËSORE NË BASHKËPRONËSI PËR DISA ZONA KADASTRALE”.

Deri datë 30.6.2016

Gjetje 5: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP), Prefektit të Qarkut Gjirokastër, për periudhën 2012-2015 i ka drejtuar ZVRPP Gjirokastër **42 kërkesa** për informacion, verifikim, konfirmim gjendjes juridike të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore (ndarë 3 jashtë juridiksioni dhe 39 në juridiksion, prej të cilave **17** janë pa përgjigje dhe 20 kërkesa me përgjigje të pa sakta e të pa plota); dhe gjithashtu nga ana e vetë ZVRPP Gjirokastër po për të njëjtën periudhë i ka drejtuar KVVTP vetëm **8 Kërkesa** për verifikim e vlerësim të titujve të pronësisë, prej të cilave 4 janë me përgjigje dhe 4 kërkesave nuk ju është përgjigjur KVVTP); gjendje kjo që tregon pamjaftueshmëri e mungesë bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve që ka sjellë si pasojë nivele të ulta të regjistrimit të pasurive bujqësore, në kundërshtim dhe në mos përmbushje të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 ”Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë, të Paluajtshme, të Fituara me Atin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “MARREDHENIET KVVTP-ZVRPP DHE ANASJELLTAS PER VLERËSIMIN E TITUJVE TË PRONËSISË ME AMTP VITI 2012-2015 ZVRPP GJIROKASTER viti 2012-2015”,bashkëlidhur (Trajtuar hollësisht në faqet 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

a. Nga mos konfirmimi, mos raportimi dhe mos identifikimi i gjendjes juridike të pasurive bujqësore ka rezultuar:

a1. Përfitime të titujve pronësie, lëshuar certifikata të pasurive të cilave është kërkuar konfirmimi nga KVVTP te rezultuara me sipërfaqe tepër për 15 pasuri me 4890 m² te llojit arë 300 m² truall, përkatësisht ndarë:

Për vitin 2013, në 5 pasuri me 651 m² te llojit arë cilësuar:

-pasuria nr. 10/66, v. 2, f. 95 zk. 2392 arë R2 për 2330 m² e Ln 2346 m² tepër + 16 m²,
-Pasuria nr. 266/1/5, v. 8, f. 222 zk. 2392 arë R1 3000m², Ln 3191m² tepër + 191m²,
-pasuria nr. 1184 v. 12, f. 146 zk. 2392, arë R₂ 2250 m² me 2594 m², **teper + 294 m²**, që i përket AMTP nr. 4919, pa datë lëshimi K/F **A.R. S.** me 8 pjesëtarë (përfshirë dhe të dy bijtë), me 4 pasuri me sipërfaqe 16780 m² me sip **teper +377 m²**, prej së cilës për **sipërfaqen tepër + 294 m² lëshuar certifikatë** datë 28.01.2009 referenca nr. 00098.

pasuria nr. 164/1, v. 4, f. 2 zk. 1058, arë R₂ i AMTP me 3780 m² me LN 3880 m², tepër + 100 m²,
pasuria nr. 215/8, v. 5, f. 68 zk. 1058, arë R₁ i AMTP nr. 1953 me 8880 m² me LN 8930 m², tepër +50 m² ndërsa në KPP lëshuar certifikatë datë 05.05.15 sipas AMTP nr. 1953 me **referencës nr. 000124**, datë 2015,

Për vitin 2014, përfituar në 9 pasuri me 3083 m² te llojit arë dhe 1 pas me 300 m² truall.

-Për **4 pasuri** me sipërfaqen tepër **1920 m²** (210+37+7+1666), të AMTP nr. 3553, datë 28.5.1993 ZK. 2956 lëshuar certifikatat përkatësisht:

-R1, pasuria nr..666/7, v. 6, f. 15 zk. 2956 arë sipërfaqe 2900 m² me 3110 m², tepër + 210 m², për të cilën është lëshuar certifikata datë 8.9.2005,

-R2, pasuria nr. 656/25, v. 6, f. 29 zk. 2956 arë sipërfaqe 4260 m² me 4297 m², tepër +37 m², për të cilën është lëshuar certifikata datë 8.9.2005,

-R3, pasuria nr.666/83, v. 6, f.191 zk. 2956 arë sipërfaqe 1500 m² me 1507 m², tepër + 7 m², për të cilën është lëshuar certifikata datë 8.9.2005,

-R4, pasuria nr.576/4, v. 5, f. 52 zk. 2956 arë sipërfaqe 2400 m² me 4066 m², tepër +1666 m², për të cilën është lëshuar certifikata datë 8.9.2005, dhe 17.8.2012.

-Për 5 pasuri me sipërfaqen tepër **+1163 m²**, të AMTP nr. 3554, datë 28.5.1993 ZK. 2956 lëshuar certifikata **1 pasuri truall 300 m²** tepër përkatësisht:

-pasuria nr. 576/6, v. 5, f. 54 zk 2956 arë 1600 m² me 2563 m² tepër +963 m², lëshuar certifikatë datë 18.10.2005 dhe 29.01.07.

-pasuria nr. 656/24, v. 6, f. 28 zk 2956 arë 2530 m² me 2730 m² tepër +200 m², lëshuar certifikatë datë 18.10.2005.

-pasuria nr. 666/8 v. 6, f. 116 zk 2956 arë 2800 m² me 3106 m², tepër +306 m², lëshuar certifikatë datë 18.10.2005 dhe 29.01.07 pa veprime në KPP,

-pasuria nr. 449/16, v. 2, f. 60, zk 2956 arë 1600 m² me 1812 m² tepër +212 m², pa veprime në KPP. Nuk është çelur KPP e pasurisë nr. 599/19, rreshtit 6 të AMTP-së, vresht sipërfaqe 400 m², çelur KPP për 2 troje me sip 600 m² përkatësisht pasuritë nr. 487/14, v. 3, fq.81 zk. 2956 sipërfaqe truall 300 m² nga e cila ndërtesë 47 m² dhe pasuria nr. 516/6, v.4, f. 89, zk. 2956 sipërfaqe truall 300 m² nga e cila ndërtesë 81 m², për të dyja nuk ka veprime në KPP; pra ka përfituar truall tepër 300 m² mbi normë në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 2 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6 1978 "Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave", ku shprehet "Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore jepet në përdorim një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²".

Për vitin 2015, në 1 pasuri me 156 m² arë nga AMTP nr. 8061 v. 1993, me 4 pasuri me 10200 m² dhe 10356 m² sipas PIII-LN fituar sipërfaqe tepër +156 m², me certifikatën datë 25.01.2007.

a2. Nuk janë veçuar e ndarë "shtet" sipërfaqet e tepërta mbi AMTP për 12 pasuritë me sipërfaqe 1748 m² arë ndarë:

Për vitin 2013 në 11 pasuri me sipërfaqe 1404 m² përkatësisht:

1. AMTP nr. 4779/1, datë 15.7.2000, me mangësi në formë e në përmbajtje ku nuk ka veprime në KPP me sipërfaqe tepër +274 m² në 2 pasuri; Pasuria nr. 76/29, v. 7, f. 234 zk. 2392 arë R1 3000m² me Ln 3220 m² tepër + 220 m² dhe Pasuria nr. 266/3/6, v.9, f. 14 zk. 2392 arë R2 3000 m² me Ln 3054 m² tepër + 54 m².

2. AMTP nr. 4802/1, datë 15.7.2000, me mangësi në formë e në përmbajtje ku nuk ka veprime në KPP me sipërfaqe tepër + 117 m² tepër në 2 pasuritë: Pasuria nr. 36/37, v. 6, f. 139 zk. 2392 arë R2 3000m² me Ln 3074 m² tepër + 74m² dhe Pasuria nr. 76/17, v.7, f. 222 zk. 2392 arë R2 1160m² me Ln 1203 m² tepër + 43 m²,

3. AMTP nr. 4801/1, datë 15.7.2000, me mangësi në formë e në përmbajtje, nuk ka veprime në KPP me sipërfaqe tepër +128 m² që u përket 2 pasurive përkatësisht:

-pasuria nr. 266/1/5, v. 8, f. 237 zk. 2392 arë R2 3000m² Ln 3085 m² tepër + 85 m²,

-Pasuria nr. 76/18, v. 7, f. 222 zk. 2392 arë R1 me 1160m² Ln 1203 m² dif + 43 m²,

4. AMTP nr. 4800/1, datë 15.7.2000, me 2 pasuri arë me sip.4160 m², me mangësi në formë e në përmbajtje, nuk ka veprime në KPP me sipërfaqe tepër +118 m² që u përket

-Pasuria nr. 36/38, v. 6, f. 140 zk. 2392 arë R1 3000m² me Ln 3076 m² dif + 76 m²,

-Pasuria nr. 76/22, v. 7, f. 227 zk. 2392 arë R2 1160m² me Ln 1202 m² dif + 42 m²,

5. AMTP nr.1677, datë 8.3.1993, me total nga 10240 m² ka 10724 m², nuk ka veprime në KPP me sipërfaqe tepër +484 m² të cilat nuk janë veçuar e regjistruar "shtet", përkatësisht:

pasuria nr. 18/9, v.1, f. 31, zk.2609, vresht 520 m² me 835 m², tepër + 315 m² dhe pasuria nr. 252/9, v.2, f.233, zk.2609, arë 1800 m² me 2104 m², tepër + 304 m² ku të veçojë 169 m².

6. AMTP nr. 4919, pa datë lëshimi K/F qytetari A.R.S. me 8 pjesëtarë (përfshirë dhe dy bijtë), sipas gjendjes v.1991 me 4 pasuri me sipërfaqe 16780 m², e cila disponon tre AMTP përkatësisht:

AMTP nr. 4919, pa datë, 4 pas 16780 m², LN 17157, tepër +377m²

AMTP nr. 4919/1, datë 15.7.2000 1 pas 3000 m², LN 3099 m², tepër + 99 m²

AMTP nr. 4919/2, datë 15.7.2000 1 pas 3000 m², LN 3101 m², tepër + 101 m²

Shuma e Familje me 8 pjesëtarë 6 pas 22780 m², LN 23357 m², tepër + 577 m²

ku nuk është veçuar e ndarë shtet sipërfaqja tepër + 577 m², nga e cila janë leshur certifikata për 294 m² tepër, ndërsa për 283 m² nuk ka transaksion e nuk është veçuar shtet.

Për vitin 2014, është 1 pasuri me +344 m² lloji arë nga AMTP nr. 1123, datë 20.10.1992 në emër të V.S.C. me 3 pasuri me sipërfaqe 12300 m², me mangësi në formë dhe në përmbajtje, nuk ka veprime në KPP me sipërfaqe tepër +484 m² dhe nuk janë veçuar e regjistruar "shtet", në -KPP pas nr. 26, v. 1, f. 71 zk. 3058 arë me sip 10900 m² sipas AMTP RII dhe 11244 m² sipas LN pra +344 m² sipërfaqe tepër,

Rekomandim 7: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa, për të inventarizuar dhe çelur dosjet përkatëse për **42 kërkesa** për informacion, verifikim, konfirmim gjendjes juridike të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore (ndarë 3 jashtë juridiksioni dhe 39 në juridiksion, prej të cilave **17** janë pa përgjigje dhe **20 kërkesa** me përgjigje të pa sakta e të pa plota); gjithashtu për **8 Kërkesa** që ZVRPP Gjirokastrë ka drejtuar KVVTP për verifikim e vlerësim të titujve të pronësisë, prej të cilave 4 janë me përgjigje dhe 4 kërkesa nuk kanë përgjigje të KVVTP); të konfirmojë realisht dhe saktësisht gjendjen juridike të pasurive me AMTP sikundër trajtuar në Raport, pasqyruar në tabelën: "MARREDHENIET KVVTP-ZVRPP DHE ANASJELLTAS PER VLERËSIMIN E TITUJVE TË PRONËSISË ME AMTP VITI 2012-2015 ZVRPP GJIROKASTER viti 2012-2015".

Menjëherë

Rekomandim 8: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të neneve 59, 60 dhe 74 të ligjit nr33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", mbi pasuritë për të cilat është kërkuar konfirmimi për verifikim nga KVVTP, të veçoje "shtet" dhe kërkojë ne rrugë ligjore anulimin e certifikatave të pronësisë të lëshuara mbi sipërfaqe **tepër për 15 pasuri me 4890 m² te llojit arë 300 m² truall, përkatësisht;**

-pasuria nr. 10/66, v. 2, f. 95 zk. 2392 arë R2 për 2330 m² e Ln 2346m² **tepër + 16 m²,**

-Pasuria nr. 266/1/5, v. 8, f. 222 zk. 2392 arë R1 3000m², Ln 3191m² **tepër + 191m²,**

-pasurisë nr. 1184 v. 12, f. 146 zk. 2392, arë R₂ 2250 m² me 2594 m², **tepër + 294 m²,** që i përket AMTP nr. 4919, pa datë lëshimi K/F qytetari **A.R.S. me 8 pjesëtarë** (përfshirë dhe dy bijtë), me 4 pasuri me sipërfaqe 16780 m², **tepër +377 m², prej së cilës për sipërfaqen tepër + 294 m² pajisur me certifikatë** datë 28.01.2009 sipas referencës nr. 00098;-pasuria nr. 164/1, v. 4, f. 2, zk.1058, arë R₂ AMTP me 3780 m² me LN 3880 m², tepër + 100 m²; -pasuria nr. 215/8, v. 5, f. 68 zk. 1058, arë R₁ i AMTP nr. 1953 me 8880 m² me LN 8930 m², tepër +50 m² pajisur me certifikatë datë 05.05.15 sipas AMTP nr. 1953 me **referencës nr. 000124,** datë 2015,

-Për **4 pasuri** me sipërfaqen **tepër 1920 m²** (210+37+7+1666), të AMTP nr. 3553, datë 28.5.1993 ZK. 2956 lëshuar certifikatat përkatësisht:

-R1, pasuria nr..666/7, v. 6, f. 15 zk. 2956 arë sipërfaqe 2900 m² me 3110 m², tepër + 210 m², për të cilën është lëshuar certifikata datë 8.9.2005,

-R2, pasuria nr. 656/25, v. 6, f. 29 zk. 2956 arë sipërfaqe 4260 m² me 4297 m², tepër +37 m², për të cilën është lëshuar certifikata datë 8.9.2005,

-R3, pasuria nr..666/83, v. 6, f.191 zk. 2956 arë sipërfaqe 1500 m² me 1507 m², tepër + 7 m², për të cilën është lëshuar certifikata datë 8.9.2005,

-R4, pasuria nr..576/4, v. 5, f. 52 zk. 2956 arë sipërfaqe 2400 m² me 4066 m², tepër +1666 m², për të cilën është lëshuar certifikata datë 8.9.2005, dhe 17.8.2012.

-Për **5 pasuri** për sipërfaqen tepër **+1163 m²,** të AMTP nr. 3554, datë 28.5.1993 ZK. 2956 lëshuar certifikatat **1 pasuri truall 300 m²** tepër përkatësisht:

-pasuria nr. 576/6, v. 5, f. 54 zk 2956 arë 1600 m² me 2563 m² tepër +963 m², lëshuar certifikatë datë 18.10.2005 dhe 29.01.07.

-pasuria nr. 656/24, v. 6, f. 28 zk 2956 arë 2530 m² me 2730 m² tepër +200 m², lëshuar certifikatë datë 18.10.2005.

-pasuria nr. 666/8 v. 6, f. 116 zk 2956 arë 2800 m² me 3106 m², tepër +306 m², lëshuar certifikatë datë 18.10.2005 dhe 29.01.07 pa veprime në KPP,

-pasuria nr. 449/16, v. 2, f. 60, zk 2956 arë 1600 m² me 1812 m² tepër +212 m², pa veprime në KPP.

pasuritë nr. 487/14, v. 3, fq.81 zk. 2956 sipërfaqe truall 300 m² nga e cila ndërtesë 47 m² dhe pasuria nr. 516/6, v.4, f. 89, zk. 2956 sipërfaqe truall 300 m² nga e cila ndërtesë 81 m², përfituar truall tepër 300 m² mbi normë

Menjëherë

Rekomandim 9: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të neneve 59, 60 dhe 74 të ligjit nr33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të veçojë e çelë KPP –të, dhe të regjistrojë “shtet” **për 12 pasuritë me sipërfaqe tepër +1748 m² arë** për të cilat kërkuar konfirmimi për verifikim nga KVVTP, të rezultuar me **sipërfaqe e tepër norme mbi AMTP që janë dhe me mangësi në formë e në përmbajtje dhe që nuk ka veprime në KPP përkatësisht:**

1. **AMTP nr. 4779/1, datë 15.7.2000, sipërfaqe tepër +274 m²** Pasuria nr. 76/29, v. 7, f. 234 zk. 2392 arë R1 3000m² me Ln 3220 m² **tepër + 220 m²**, Pasuria nr. 266/3/6, v.9, f. 14 zk. 2392 arë R2 3000 m² me Ln 3054 m² **tepër + 54 m²**.

2. **AMTP nr. 4802/1, datë 15.7.2000 me sipërfaqe tepër + 117 m² tepër në pasuritë** Pasuria nr. 36/37, v. 6, f. 139 zk. 2392 arë R2 3000m² me Ln 3074 m² **tepër + 74m²**, Pasuria nr. 76/17, v.7, f. 222 zk. 2392 arë R2 1160m² me Ln 1203 m² **tepër + 43 m²**,

3. **AMTP nr. 4801/1, datë 15.7.2000, me sipërfaqe tepër 128 m² që u përket 2 pasurive përkatësisht:-** pasuria nr. 266/1/5, v. 8, f. 237 zk. 2392 arë R2 3000m² Ln 3085 m² **tepër + 85 m²**, -Pasuria nr. 76/18, v. 7, f. 222 zk. 2392 arë R1 me 1160m² Ln 1203 m² **tepër + 43 m²**,

4. **AMTP nr. 4800/1, datë 15.7.2000, me 2 pasuri arë me sip, 4160 m², me sipërfaqe tepër 118 m² ,-** Pasuria nr. 36/38, v. 6, f. 140 zk. 2392 arë R1 3000 m² me Ln 3076 m² **tepër + 76 m²**, -Pasuria nr. 76/22, v. 7, f. 227 zk. 2392 arë R2 1160m² me Ln 1202 m² **tepër + 42 m²**,

5. **AMTP nr.1677, datë 8.3.1993, me total nga 10240 m² ka 10724 m², me sipërfaqe tepër +484 m² KPP pasuria nr. 18/9, v.1, f.fq 31, zk.2609, vresht 520 m² me 835 m², tepër + 315 m² KPP nr. 252/9, v.2, f.233, zk.2609, arë 1800 m² me 2104 m², tepër + 304 m², dhe veçojë 169 m² .**

6. **AMTP nr. 4919, pa datë lëshimi K/F A.R.S. me 8 pjesëtarë (përfshirë dhe dy bijtë), gjendje familjes v.1991 me 4 pasuri me sipërfaqe 16780 m² dhe dy prestatë bijë sipas gjendjes v.1991 të familjes e cila disponon 3 AMTP përkatësisht:**

AMTP nr. 4919, pa datë, 4 pas 16780 m², LN 17157, tepër +377m²

AMTP nr. 4919/1, datë 15.7.2000 1 pas 3000 m², LN 3099 m², tepër + 99 m²

AMTP nr. 4919/2, datë 15.7.2000 1 pas 3000 m², LN 3101 m², tepër + 101 m²

Shuma e Familje me 8 pjesëtarë 6 pas 22780 m², LN 23357 m², tepër + 577 m²

ku nuk është veçuar e regjistruar shtet sipërfaqja tepër +577 m², nga e cila janë lëshur certifikata për 294 m² tepër, ndërsa për 283 m² nuk ka transaksion e nuk është veçuar shtet.

7. **AMTP nr. 1123, datë 20.10.1992 në emër të V.S.C. me 3 pasuri me sipërfaqe 12300 m², me sipërfaqe tepër +484 m² -KPP pas nr. 26,v. 1, f. 71 zk. 3058 arë me sip 10900 m² sipas AMTP RII dhe 11244 m² sipas LN, pra sipërfaqe tepër +344 m²,**

Rekomandim 10: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të neneve 59, 60 dhe 74 të ligjit nr33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, deri në identifikimin, verifikimin, raportimin e pasurive të 3 AMTP-ve përkatësisht; AMTP nr. 5589/1, datë 20.10.2000, AMTP nr. 1735, datë 20.8.1992 lëshuar **qytetarit K.K.V dhe AMTP nr. 185, datë 2.3.1992 me sipërfaqe totale 20170 m² tokë bujqësore.**

Menjëherë

Gjetje 5: ZVRPP Gjirokastrë, në *hyrjen në sistem janar 2001*, ka pranuar e marrë në dorëzim prej NJMP, 184 KPP të v. 1, zk 2156 dhe 250 KPP të v. 2, zk.2156 fshati Klisharë **414 pasuri** bujqësore të llojit pemëtore me gjendje pronësie status juridik “shtet” të cilat në KPP evidentohen të poseduara pa tituj pronësie nga persona të fshatit Klisharë, gjendje kjo jo reale e krijuar nga NJMP e cila nuk ka kryer menaxhimin e saktë të zonës për 2 volume duke mos u mbështetur në AMTP-të që zotërojnë K/Familjarët e Fshatit Klishar zk. 2156, në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe me ligjin nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar hollësisht në faqet 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 11: ZVRPP Gjirokastrë dhe ZQRPP Tiranë të kryejnë menaxhimin e ZK 2156 fshati Klishar sipas AMTP-ve për **414 pasuritë** e llojit pemëtore, hyrë në sistem në janar 2001 të identifikojë, çelë dhe plotësojë **164 KPP** të vol.1 dhe **250 KPP** të vol. 2, zk. 2156 fshati Klishar të pasurive lloji pemëtore e pasuri të tjera bujqësore sipas AMTP-ve të disponuar nga K/familjarët e fshatit Klishar.

Deri datë 31.7.2016

Gjetje 6: ZVRPP Gjirokastrë për periudhën 2012-2015 i ka drejtuar KVVTP vetëm **8 Kërkesa** për verifikim e vlerësim të titujve të pronësisë, prej të cilave 4 janë me përgjigje dhe 4 kërkesave nuk ju është përgjigjur KVVTP); gjendje kjo që tregon pamjaftueshmëri e mungesë bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve që ka sjellë si pasojë nivele të ultë të regjistrimit të pasurive bujqësore por dhe mos kufizimin e marrjen e masave deri në përfundim të procedurave që kanë sjellë përfitim tituj pronësie të jashtëligjshëm **për 12 AMTP-ve** (nr.7485/2, datë 24.5.1996, nr.5603, datë 15.11.1992, nr.5603/1, datë 30.01.2000 nr. 2107/1 date 25.5.93, nr. 2107/2 datë 5.5.2000, nr. 2076 date 25.2.93, nr.2076/1 date 5.5.2000, nr. 3740, datë 20.7.1993, nr.3799, datë 20.7.1993, nr.3800, datë 20.7.1993, nr.203, datë 2.03.1992, nr. 8070, pa datë – 1993, nr. 4429, pa datë, nr. 4429, datë 30.08.1994),

me sipërfaqe 56 952 m² prej të cilave sipërfaqet e tepërta 3469 m² në 12 pasuri are pemëtore dhe 1240 m² truall, lëshuar certifikatave në **4 pasuri** me sipërfaqe tepër **1390 m²**, për të cilat ZVRPP ka kërkuar verifikim titullit në KVVTP, në kundërshtim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë, të Paluajtshme, të Fituara me Atin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “MARREDHENIET KVVTP-ZVRPP DHE ANASJELLTAS PER VLERËSIMIN E TITUJVE TË PRONËSISË ME AMTP VITI 2012-2015 ZVRPP GJIROKASTER viti 2012-2015”,bashkëlidhur (Trajtuar hollësisht në faqet 34-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

a. Nga mungesa e përgjigjes nga KVVTP dhe mos vazhdimi i procedurave të vlerësimit nga ZVRPP dhe mos identifikimi i gjendjes juridike të pasurive bujqësore ka rezultuar:

a1. Përfitime të titujve pronësie në 12 AMTP me sipërfaqe 56 952 m² nga të cilat 12 pasuri me sipërfaqe tepër 3469 m² tokë bujqësore dhe 1240 m² truall si dhe lëshuar certifikata në 4 pasuritë me sipërfaqe tepër 1390 m², pasuri për të cilat është kërkuar verifikimi nga ZVRPP por nuk janë çuar në fund procedurat ,

a2. Nuk janë marrë masa kufizuese dhe nuk janë ndjekur procedurat për verifikimin e tit pronësisë pra nuk është vepruar sipas neneve 59,60 dhe 74 për kufizim dhe veçim sipërfaqe tepër “shtet”, sa kohe që ka lindur ngjarja e verifikimit, **për 12 AMTP-ve me sipërfaqe 56 952 m² prej të cilave sipërfaqet e tepërta 3469 m² në 12 pasuri are pemëtore dhe 1240 m² truall** për të cilat është kërkuar verifikimi i titullit nga ZVRPP në KVVTP dhe për certifikata lëshuar në **4 pasuritë** me sipërfaqe tepër **1390 m²**, në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”

Rekomandim 12: Regjistruesi i ZVRPP Gjirrokastër të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të neneve 59, 60 dhe 74 të ligjit nr33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, deri në përfundimin e procesit të vlerësimit të **12** AMTP-ve (nr.7485/2, datë 24.5.1996, nr.5603, datë 15.11.1992, nr.5603/1, datë 30.01.2000 nr. 2107/1 date 25.5.93, nr. 2107/2 datë 5.5.2000, nr. 2076 date 25.2.93, nr. 2076/1 date 5.5.2000, nr. 3740, datë 20.7.1993, nr.3799, datë 20.7.1993, nr.3800, datë 20.7.1993, nr.203, datë 2.03.1992, nr. 8070, pa datë – 1993, nr. 4429, pa datë, nr. 4429, datë 30.08.1994) **me sipërfaqe 56 952 m² prej të cilave për sipërfaqet e tepërta +3469 m² në 12 pasuri are pemëtoare dhe + 1240 m² truall** për të cilat është kërkuar verifikimi i titullit nga ZVRPP në KVVTP, të kërkojë shfuqizimin e certifikatave lëshuar në **4 pasuritë** me sipërfaqe tepër **1390 m²**, të veçojë çelë KPP e regjistrojë “shtet” pasuritë me sipërfaqe tepër **që i përkasin AMTP-ve me mangësi në forme e në përmbajtje për të cilat nuk ka veprime në KPP.**

Menjëherë

Gjetje 7: ZVRPP Gjirrokastër nuk një evidencë raportuese për aplikimet dhe regjistrimet e kontratave të përdorimit dhe qiradhënies se PPL publike për periudhën 2012-2015 por nga auditimi me zgjedhje ZVRPP Gjirrokastër ka prerë fletë aplikimet e pranuar dokumentacioni i paraqitur nga persona fizik për regjistrime të 10 kontratave për marrje në përdorim dhe me qira të pasurive të paluajtshme publike prej të cilave **5 kontrata** për marrje në përdorim dhe me qira **8 pasuri të llojit pyll** me **sipërfaqe pyjore 86,3 ha²**, **2 kontrata për marrje me qira të 2 pasurive të llojit kullotë me sipërfaqe kullosore 7,35 ha; 4 pasuri për marrje me qira të sipërfaqes prej 36,72 ha lumore, shtratit dhe anëve nga e cila: 2,65 ha për kullotë dhe 33,9 ha për tokë bujqësore nga zëri kadastral Lumë**, pasqyruar në tabelën “Kontrata dhënie përdorimi dhe qiraje të PPL Shtetërore e Publike të aplikuara për regjistrim dhe të regjistruara nga ZVRPP Gjirrokastër v. 2013, 2014 dhe 2015”, bashkëlidhur.

Për **9 kontratat** (kontratat nr.2994 me 2 pasuri, nr.1211 me 2 pasuri, nr.1345 me 1 pasuri, nr.1399 me 3 pasuri përkatësisht sipas tabelës I,II,III,IV,V,VI,VII, IX,X,) me objekt dhënie në përdorim dhe me qira personave fizik të hartuara nga ish Njësitë Vendore Komuna Cepo dhe Komuna Picar me noterët z. B. Xh. dhe znj.G.R.K. si dhe të pranuar nga ZVRPP Gjirrokastër për regjistrim, kanë mangësi në përmbajtje e në formë dhe janë në kundërshtim me nenet 803,827,830 dhe 835 të Kodit Civil miratuar me ligjin **nr. 7850,datë 29.7.1994, i ndryshuar, pasi mungon** Akti i Dorëzimit të sipërfaqeve pyjore kullosore, nuk është përcaktuar vlera apo çmimi i dhënies në përdorim, të pyllit apo detyrimi në natyrë si (m³ dru zjarri, lëndë druri, kg bar apo gjethe, kg bimë medicinave(mjekësore), mbajnë afate lidhje për 99 vjet, janë sjellë dorazi për aplikim në ZVRPP Gjirrokastër dhe jo zyrtarisht nga noterët, në kundërshtim me nenin 38, pika 3 e ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, kanë mangësi në përmbajtje, sidomos në origjinën e titujve të pronësisë së pasurisë së paluajtshme, mbartin mangësi e shkelje lidhur me identifikimin e pasurive të regjistruara si dhe regjistrimi i kontratave përdorimit dhe e qera nga ZVRPP Gjirrokastër kanë sjellë si pasoje të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën **473,900** lekë për vitin 2013 prej **372,400 lekë** prej të cilës: **300,000 lekë** kamatë vonesa për ZVRPP, **66,200** lekë qera e pa likuiduar për vitin e regjistrimit të kontratës dhe **6,200** lekë tatim qeraje për vitin 2014 vlerën **60.900** lekë dhe vitin 2015 vlerën **40,600** lekë kamatëvonesa nëse do regjistroheshin, pasqyruar në tabelën “**Përmbledhëse e PPL Shtetërore e Publike Sipas llojit për regjistrim Kontrata përdorimi e qiraje dhe dëmet Ekonomike të pa aplikuara nga ZVRPP Gjirrokastër v. 2013,2014 dhe 2015** (Trajtuar më hollësisht në faqet 86-103 të Raportit të Auditimit).

Rekomandim 13: ZVRPP Gjirrokastër të marrë masa të nxjerrë urdhër të posaçëm të fshijë regjistrimet për **9 kontratat** (kontratat nr. 2994 me 2 pasuri, nr. 1211 me 2 pasuri, nr.1345 me 1 pasuri, nr. 1399 me 3 pasuri përkatësisht sipas tabelës I,II,III,IV,V,VI,VII, IX,X) me objekt dhënie përdorimi e qiraje në seksionin “D”, të KPP-ve të pasurive pasqyruar tabelën “**Kontrata dhënie përdorimi dhe qiraje të PPL Shtetërore e Publike të aplikuara për regjistrim dhe të**

regjistruara nga ZVRPP Gjirokastrë v. 2013, 2014 dhe 2015”, të kthejë zyrtarisht dokumentacionin (kontratat e Përdorimit dhe Qirasë të regjistruara dhe të pa regjistruara v. 2015) personit fizik dhe Njësisë Qeverisjes vendore që ka juridiksionin, Bashkisë Gjirokastrë,

Menjëherë

Gjetje 8: ZVRPP Gjirokastrë nuk ka një evidencë dhe nuk njihet e raportohet gjendja e pasurive të regjistruara me mbivendosje, as nuk raportohet ndjekja e procedurave ligjore për trajtimin e pasurive me mbivendosje si dhe nuk raportohet ecuria e zgjidhjes dhe pjesëmarrja e kësaj zyre në seancat gjyqësore. Gjithashtu mungojnë hartat e pasurive të identifikuar me mbivendosje. Kjo gjendje vazhdon të jetë vite më parë dhe për secilin prej viteve **2012-2015, në kundërshtim** me nenin 10 “Përparësia e regjistrimit”, të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me Kreun V, nenit 37, paragrafi i 3, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme, dhe me rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar Kreu i VI, pikat 5 dhe 5.2; dhe që nga neglizhenca e moszbatimi i procedurave ligjore ka sjellë si pasojë cenim të paanësisë së ZVRPP ndërmjet palëve në trajtimin e mbivendosjeve si dhe ka sjellë si pasojë regjistrime me mbivendosje me pasuritë e VKKP nr. 134, datë 13.3.2008, njoftuar më parë me procesverbalin e dorëzimit datë 11.08.2008, për shkak të refuzimit e mosveprimit për regjistrim dhe regjistrimet për **40 pasuri** me sipërfaqe totale **17100,9 m²** të llojit truall me ndërtesa ndarë: **12 pasuri me sipërfaqe 7360 m²** në vitin 2009, **10 pasuri me sipërfaqe 3441 m²** në vitin 2010, **7 pasuri me sipërfaqe 742,5 m²** në vitin 2011, **5 pasuri me sipërfaqe 1694,9 m²** në vitin 2012 dhe **6 pasuri me sipërfaqe 3862,5 m²** në vitin 2013, pasuri të regjistruara këto me mbivendosje dhe duke mos ndjekur procedurat ligjore për zgjidhjen e mbivendosjeve, trajtim të pabarabartë e favorizim të palëve, moszbatimin e afatit 1 mujor të KPA, mos nxjerrjen e urdhrat administrativ për refuzimin e regjistrimit, të pjesëve të mbivendosura, për pasuritë pasqyruar në tabelën emërtuar: **“Regjistrime pasurish me mbivendosje dhe transaksione pas datës 11.08.2008 mbi sipërfaqet e kthyer në VKKP nr. 134, datë 13.3.2008”**(Trajtuar në faqet 153-156 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 14: ZQRPP Tiranë dhe ZVRPP Gjirokastrë, të fillojnë procedurat ligjore, (të neglizhuar dhe pa zbatuara me parë me pasoja subjektive dhe cenimit të paanësisë së ZVRPP ndërmjet palëve), të hartojnë dokumentacionin përkatës ligjor dhe të ndjek procedurat ligjore dhe ecurinë e procesit gjyqësor, lidhur me **40 pasuri** me sipërfaqe totale **17100,9 m²** të llojit truall dhe ndërtesa ndarë: **12 pasuri me sipërfaqe 7360 m²** në vitin 2009, **10 pasuri me sipërfaqe 3441 m²** në vitin 2010, **7 pasuri me sipërfaqe 742,5 m²** në vitin 2011, **5 pasuri me sipërfaqe 1694,9 m²** në vitin 2012 dhe **6 pasuri me sipërfaqe 3862,5 m²** në vitin 2013, pasuri këto të rezultuara me mbivendosje, në tabelën emërtuar: **“Regjistrime pasurish me mbivendosje dhe transaksione pas datës 11.08.2008 mbi sipërfaqet e kthyer në VKKP nr. 134, datë 13.3.2008”**.

Menjëherë

Rekomandim 15: ZVRPP Gjirokastrë të analizoje gjendjen e nxjerrë përgjegjësinë, të marrë masa të evidentojë, vendosë database dhe komunikojë atë brenda stafit, të krijojë hartat e pasurive të identifikuar me mbivendosje dhe të munguara si dhe të ndjekë e të raportojë ecurinë e procedurave ligjore të trajtimit pasurive të regjistruara me mbivendosje mbi prona të regjistruara me parë.

Menjëherë

Gjetje 9: ZVRPP Gjirokastrë me referencën **nr. 4035, datë 13.01.2005**, aplikimi nr. 48, (nr. 0116949) datë **13.01.2005** ka regjistruar çelur KPP e pasurisë nr. 6/23, v. 15, f. 32, zk. 8541, lloji truall me sipërfaqe 729 m² në pronësi të z. I.K.B., ndodhur në lagjen “18 Shtatori”. Regjistrimi i pasurisë nr. 6/23, v. 15, f. 32, zk. 8541, lloji truall me sipërfaqe 729 m² rezulton pa titull pronësie pasi është bazuar në shkresën nr. 9, datë 13.01 1998, emërtuar “Mbi kompensimin fizik të pronarit I.K.B.”, lëshuar dhe nënshkruar nga z.B.H. në emër dhe për Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Këshillit të Rrethit Gjirokastrë, ku mungojnë firmat e anëtarëve të komisionit pra titulli pronësisë, pasi dokumenti emërtuar “Mbi kompensimin fizik të pronarit I.K.B.”, nuk përbën titull

pronësie sepse i mungon forma dhe përmbajtja ligjore e një akti administrativ, vendimit të KKKP me pjesët përbërëse si (pjesa referuese, faktet dokumentet e shpronësimit origjina e pronës, si dhe pjesa vendimmarrëse për kthim apo kompensim), mungon nënshkrimi i të 5 anëtarëve të KKKP, mungon origjina e pronës, harta etj; pra është në kundërshtim me ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe në kundërshtim me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave të ish pronarëve”, nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”,

-KPP nr. 6/23, v. 15,f. 32 zk. 8541, lloji truall me **sipërfaqe 729 m²** është pa vulë e pa firmë të regjistruarit si dhe pa firmën e juristit apo specialistit që ka kryer regjistrimin e pronës ne seksionin “C”,

Gjithashtu ZVRPP Gjirokastrë mbi pasurinë nr. 6/23, v. 15,f. 32 zk. 8541, lloji truall me sipërfaqe 729 m² ka kryer transaksione si:

-Me **referencën nr. 9041, datë 8.2.2011**, (referencë e cila mungon në arkiv dhe nuk u dorëzua për auditim), por sipas regjistrimeve në KPP **pasuria “mëmë” nr. 6/23, v. 15,f. 32 zk. 8541, lloji truall me sipërfaqe 729 m²**, është mbyllur dhe ndarë në:

-Pasurinë nr. 6/95,v. 28, f. 206, zk. 8541 e llojit truall me sipërfaqen 585,9 m², regjistruar në pronësi të I.K.B.,

-Pasurinë nr. 6/96, v. 28, f. 207, zk. 8541 e llojit truall me sipërfaqen 143,¹ m², regjistruar në pronësi **“shtet”. regjistrim për të cilin mungonte dokumentacioni akti ligjor a nën ligjor, por dokumentit “Shpallje kërkesë për shpronësim”, me objekt “Pronarët që do të shpronësohen nga ndërtimi i rrogës dhe rehabilitimi i kanalizimeve në shëtitoren “18 Shtatori” në qytetin e Gjirokastrës”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 15.4.2005 me numrin rendor të emrave nr. 5. I.K.B., për truallin 143,1 m², me çmim 4000 lekë/m² është paguar vlera 572,400 lekë,**

-Me **referencën nr. 9198, datë 6.4.2012**, aplikim nr. 798 (0647959), datë 21.7.2011,mbi pasurinë nr. 6/95,v. 28, f. 206, zk. 8541 llojit truall me sipërfaqen 585,9 m², regjistruar në pronësi të I.K.B.,është regjistruar objekti ndërtesë lokal 2kt me sipërfaqe ndërtimi 222 m². Ky regjistrim është pa Inventar dokumentacioni të dosjes, ndërsa dhe dokumentacioni nr. 1531/1, datë 21.7.2011 si: Leja e ndërtimit, formulari nr 4 përcakton si firmë ndërtuese personin K.K. pa përcaktuar identitetin e këtij subjekti si emrin e personit, nr. dhe datë të licencës; ndërkohë që vërtetimi nr. 172, datë 24.8.2011 shprehet për subjektin I. C., *pra nuk përputhet me emrin e subjektit ndërtues për të cilin është dhënë leja e ndërtimit*,

-Leja e ndërtimit nuk **përcakton pronësinë dhe as përmend dokumentin e pronësisë mbi truallin për të cilin është dhënë kjo leje ndërtimi**, ne kundërshtim me nenin 45 të ligjit nr. 8405, datë 17.8.1998 “Për urbanistikën”. Proces verbali i kolaudit datë 16.11.1998 nuk është sipas formës standarde në përmbajtje pasi: nuk përmend pronësinë mbi truallin, nuk përcakton vlerën e punimeve sipas situacionit përfundimtar dhe as vlerën e tarifës së ndërtimit të likuiduar si taksë e ndikimit në mjedis nga ndërtimet e reja, nuk përmend datën e fillimit dhe mbarimit të punimeve, etj pra është në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

- Dokumenti datë 23.9.1994 vërtetim i lëshuar nga BK për ngurtësimin e shumës 125,500 lekë nuk tregon as qëllimin e as destinacionin dhe as se për llogari të kujt kreditori është vendosur shuma e pretenduar dhe mbi të gjitha shuma nuk është xhiruar për ndonjë destinacion.

Gjithashtu në dokumentet e referencës nr. 9198, datë 6.4.2012 u gjet vërtetim pronësie nga regjistri hipotekor **nr. 223, datë 6.3.1998**, sipas të cilit është regjistruar pronësia mbi pasurinë nr. 6/95 zk 8541 llojit truall me sipërfaqe 585,9 m² **lëshuar datë 07.2.2011** në pronësi të z. I.K.B., **firmosur nga z. A.P. me detyrë ish Regjistruar dhe z. K. R. ish Hartograf**. Ky fakt tregon se kanë dhënë titull të jashtëligjshëm pronësie dhe kanë vepruar me sistem të dyfishtë regjistrimi; pra në një anë me regjistrim hipotekor dhe në anën tjetër me sistem të KPP regjistrim sporadik.

Nga veprimet e mësipërme pra mbajtja e titullit të jashtë ligjshëm të pronësisë dhe referuar urdhrit nr. 473, datë 30.7.2012 ku shprehet qartazi se; "...mungon akti ligjor i fitimit të pronësisë së truallit sipas nenit 193 dhe 195 të KC," për pasurinë nr. 6/95, v. 28, f. 206, zk. 8541 me nr. hip 211, datë 24.8.2011 llojit truall me sipërfaqen 585,9 m² mbi të cilën ngrihet objekti ndërtesë lokal 2kt me sipërfaqe ndërtimi 222 m², ka ardhur **dëm ekonomik në vlerën totale prej 16,048,170 lekë** ndarë: vlera prej **15,467,670 lekë** si nivel qiraje për zaptimin pa titull pronësie të pasurisë nr. 6/95, v. 28, f. 206, zk. 8541 e llojit truall me sipërfaqen 585,9 m² dhe vlera **572,400 lekë si përfitim i jashtë ligjshëm në vlerën e kompensimit** pa pasur titull ligjor të pronësisë për sipërfaqen prej **143,1 m² përkatësisht** truallit të pasurisë nr. 6/96, v. 28, f. 207, zk. 8541 e llojit truall me sipërfaqen 143,1 m² dhe vlera **8,100 lekë kamatë vonesa për regjistrim të vonuar** (Trajtuar hollësisht në faqet 170-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 16: ZVRPP Gjirokastrë, Regjistruesi të nxjerrë urdhër të veçantë të mbyllë KPP nr. 6/95, v. 28, f. 206, zk. 8541 e llojit truall me sipërfaqen **585,9 m²**, mbi të cilën ngrihet ndërtesa 2kt në sipërfaqe ndërtimi 222 m² me funksion shërbimi, të çelë KPP e re nr., v. fq. Zk 8541 për llojin truall me sipërfaqe 585,9 m², regjistrojë ne pronësi "Shtet", të çelë KPP nr. v. f. Zk 8541 ku të regjistroje pasurinë e llojit ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 222 m² dhe mbi këtë pasuri të vendoset barrë kufizuese në vlerën prej 16,048,170 lekë (15,467,670 lekë qira e pa paguar + 572,400 lekë vlerë për shpronësimin e marrë), deri në likuidimin e vlerës së dëmit ndaj Bashkisë Gjirokastrë për vlerën e Qirasë munguar nga përdorimi i jashtëligjshëm e pa titull pronësie të truallit prej 585,9 m² dhe ndaj Buxhetit të shtetit për vlerën e shpronësimit të përfituar pa drejtësisht e pa titull pronësie të truallit në sipërfaqen 143,1 m².

Menjëherë

Gjetje 10: ZVRPP Gjirokastrë me referencën **nr. 180, datë 15.11.2012** ka regjistruar dhe lëshuar certifikata datë **15.11.2012 pronësie në emër të Komunës Picar për 2 pasuri të llojit Pyje në sipërfaqen 79 ha përkatësisht pasuria nr. 304/9, v. 11, f. 66, zk. 2956, e llojit pyll me sipërfaqe 430000 m²(43ha) lëshuar certifikata nr. 476216, dhe Pasuria nr. 304/10, v. 11, f. 67, zk. 2956, e llojit pyll me sipërfaqe 360000 m²(36 ha) lëshuar certifikata nr. 476217 (pasuri të cilat më pas Komuna i ka dhënë në përdorim me afat 99 vjet) pa dokumentacionin e marrjes në dorëzim dhe dorëzimit nga enti përfaqësuesi Shtetit, (pasi mungon dokumentacioni si procesverbal, harta, kadastra pyjore, fuqi lëndore etj) në kundërshtim ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" pra dhe në kundërshtim me pikën 2, lidhja 1 si dhe me pikën 3 të VKM nr. 661, datë 21.5.2008" Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, Pyje dhe Kullota, që do të Transferohen ne Pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendore, Komuna Picar të Qarkut të Gjirokastrës" (Trajtuar hollësisht në faqet 184-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Rekomandim 17: ZVRPP Gjirokastrë të nxjerrë urdhër kufizimi në bazë të nenit 59,80 dhe 74 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" për 2 pasuri të llojit Pyje në sipërfaqen 79 ha përkatësisht pasuria nr. 304/9, v. 11, f. 66, zk. 2956, e llojit pyll me sipërfaqe 430000 m²(43ha) lëshuar certifikata nr. 476216, dhe Pasuria nr. 304/10, v. 11, f. 67, zk. 2956, e llojit pyll me sipërfaqe 360000 m²(36 ha) lëshuar certifikata nr. 476217, deri në plotësimin e dokumentacionit të munguar, procesverbalit dorëzimit nga DSHP.

Menjëherë

Gjetje 11: ZVRPP Gjirokastrë, nga të dhënat e KPP-ve, me referencën **nr. 188, datë 3.5.2013 (referencë e cila mungonte e nuk ish dorëzuar në arkivë) pa titull pronësie ligjore me mungesë dokumentacioni** ka regjistruar dhe lëshuar certifikatën **nr. 602642 datë 6.5.2013 për pasurinë nr. 1143/3, v. 10, f. 14 zk. 2956 e llojit "Përrua", me sipërfaqe 339 057 m²(33,9 ha) në pronësi të Komunës Picar (pasuri të cilën më tej Komuna i ka dhënë në përdorim e me qira afat 99 vjet).** Kjo pasuri sipas VKM nr. 22, datë 12.01.2011 dhe listës "Formular Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore" fletës nr. 62, në numrin rendor 414 ZK 2956 pasuria nr. 1143/3 nen emërtesën "Përrua", me komponentët përbërës (shtrati, rrjedha dhe brigjet), ndodhur në Picar me

sipërfaqe 339 057 m²(33,9 ha), me funksion “Burime natyrore” me përgjegjësi administrative e status juridik përdorimi MMPAU (Ministria e Mjedisit Peshkimit dhe Administrimit të Ujërave), sipas Lidhjes 1, kjo pasuri nuk përfshihet në pronat që i transferohen Komunës Picar. Pra regjistrimi i pasurisë nr. 1143/3, v. 10, f. 14 zk. 2956 e llojit “Përrua”, me sipërfaqe 339 057 m²(33,9 ha) në pronësi të Komunës Picar është në kundërshtim ligjin nr. 33, datë 21.03.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” neni 25,”Mënyra e Regjistrimit fillestar”, germa (a) ku shprehet se:”..pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë sipas nenit 193 të Kodit Civil...”, dhe në kundërshtim me VKM nr. 22, datë 12.01.2011 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen në Pronësi ose në Përdorim të Komunës Picar, të Qarkut të Gjirokastrës (Trajtuar më hollësisht në faqet 184-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 18: ZVRPP Gjirokastrë të nxjerrë urdhër në bazë të nenit 25 germa (a) të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe nenit 193 të Kodit Civil...”, të fshijë regjistrimin nga pronësia Komunës Picar dhe të regjistrojë“Shtet” pasurinë nr. 1143/3, v. 10, f. 14 zk. 2956 e llojit “Përrua”, me sipërfaqe 339 057 m²(33,9 ha) me përgjegjësi administrative dhe me status juridik përdorimi MMPAU (Ministria e Mjedisit Peshkimit dhe Administrimit të Ujërave).

Menjëherë

Gjetje 12: ZVRPP Gjirokastrë, nga të dhënat e KPP-ve, me referencën nr. 033, datë 22.7.2013, (referencë e cila mungonte e nuk ish dorëzuar në arkivë) pa titull ligjor pronësie, me mungesë dokumentacioni ka regjistruar 3 pasuri ndodhur në Komunën Cepo, Ura e Kardhiqit, fshati Prongji përkatësisht: 1. pasurinë nr. 477/4,v. 3, f. 179, zk. 3058, lloji kullotë (Lumë) me sipërfaqe 16740 m² (1,67 ha), lëshuar certifikatë pronësie nr. 603360, datë 22.7.2013, në emër të Komunës Cepo, në zërin “Lumë”, pra ndryshe nga KPP që mban “Kullotë”;2.-Pasurinë nr. 226/2,v. 3, f. 178 zk. 3058, lloji Kullotë me sipërfaqe 9512 m² (0,95 ha) lëshuar certifikata e pronësisë nr. 603363, datë 22.7.2013 në emër të Komunës Cepo; 3.- Pasurinë nr. 477/5,v. 3, f. 180 zk. 3058, lloji Lumë, me sipërfaqe 1748 m² (0,17 ha) lëshuar certifikata e pronësisë nr. 603361, datë 22.7.2013 në emër të Komunës Cepo, (Më pas 3 pasuritë me referencën nr. 035, datë 15.08.2013, janë dhënë me qira me afat 99 vjet nga Komuna Cepo me Kontratën nr.1399 rep, nr. 700 kol, datë 05.08.2013 dhe janë lëshuar certifikatat përkatëse të Qiradhënies nga ZVRPP Gjirokastrë, veprim i cili është shënuar në KPP-të përkatëse;

Tri pasuritë sipas rubrikës “Përshkrim i veçantë” të KPP-ve pretendohet së kanë origjinë sipas shënimit “referenca nr. 33, datë 22.7.2013 dhe VKM nr. 748, datë 28.5.2008“, pra VKM nr. 748, datë 28.5.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, Pyje dhe Kullota, që do të Transferohen në Pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendor, Komuna Cepo, të Qarkut të Gjirokastrës”; por sipas këtij vendimi listës përfundimtare, me 10 fletë, me përfundim numrin rendor 264, që i bashkëlidhen si pjesë përbërëse e vendimit. Nga auditimi rezulton se: të tri pasuritë nuk përfshihen në asnjë prej 264 pasurive të listës “Formular për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore” (Mbështetur në Inventarizimin e pronave të veçanta të tipit Kullota, Livadhe, Shkëmbore etj.) pra nuk janë objekt e pjesë e VKM nr. 748, datë 28.5.2008 dhe ndodhen brenda në shtrat dhe buze shtratit të lumit Kardhiq. Pra regjistrimi i sipërfaqes lumore prej 2,79 ha, në 3 pasuri nr. 477/4,v. 3, f. 179, zk. 3058, lloji kullotë në fakt (Lumë) me sipërfaqe 16740 m² (1,67 ha), nr. 226/2,v. 3, f. 178 zk. 3058, lloji kullotë me sipërfaqe 9512 m² (0,95 ha) dhe nr. 477/5,v. 3, f. 180 zk. 3058, lloji Lumë, me sipërfaqe 1748 m² (0,17 ha) është në kundërshtim ligjin nr.33, datë 21.03.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” neni 25,”Mënyra e Regjistrimit fillestar”, germa (a) ku shprehet se:”..pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë sipas nenit 193 të Kodit Civil...”, dhe në kundërshtim me VKM nr. 748, datë 28.5.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, Pyje dhe Kullota, që do të

Transferohen në Pronësi Të Njesisë së Qeverisjes Vendor, Komuna Cepo, të Qarkut të Gjirokastrës”(Trajtuar më hollësisht në faqet 184-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 19: ZVRPP Gjirokastrë të nxjerrë urdhër në bazë të nenit 25 germa (a) të ligjit **nr. 33, datë 21.03.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe nenit 193 të Kodit Civil...”,** për fshirjen e regjistrimit nga pronësia e Komunës Cepo dhe regjistrimin “Shtet” të sipërfaqes lumore prej 2,79 ha, përkatësisht tre pasurive nr. 477/4,v. 3, f. 179, zk. 3058, lloji kullotë në fakt (Lumë) me sipërfaqe 16740 m² (1,67 ha), nr. 226/2,v. 3, f. 178 zk. 3058, lloji Kullotë me sipërfaqe 9512 m² (0,95 ha) dhe nr. 477/5,v. 3, f. 180 zk. 3058, lloji Lumë, me sipërfaqe 1748 m² (0,17 ha) të ndodhura në shtratin e lumit Kardhiq **me përgjegjësi administrative dhe me status juridik përdorimi MMPAU (Ministria e Mjedisit Peshkimit dhe Administrimit të Ujërave).**

Menjëherë

Gjetje 13: ZVRPP Gjirokastrë, sipas KPP-se, me referencën **nr. 0204, datë 25.4.2014, në emër të Komunës Picar ka** regjistruar dhe lëshuar certifikate pronësie nr. 606360, datë 2.4.2014 të pasurisë nr. 1375, v. 11, f. 86 zk. 2956, me sipërfaqe 33500 m² (3,35 ha), **lloji kullotë**, por në fakt sipas VKM nr. 661, datë 21.05.2008 është (pyll) pjesë e pasurisë 26,5 ha pyll ndodhur në “Hija e Kacojthit”, Komuna Picar, pa bërë **aplikimit ndarje pasurie dhe hartë treguese pra të ardhura të munguara 1700 lekë (700+1000)**, pa dokumentacion të ndryshimit të zërit kadastral nga “pyll” në “kullotë” dhe pa dokumentacionin e marrjes në dorëzim dhe dorëzimit të pasurisë nga Mbajtësi përfaqësuesi shtetëror DSHP tek Komuna Picar, veprime **në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 ”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”,neni25”Mënyra e Regjistrimit fillestar”, germa (a) ku shprehet se:”..pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë sipas nenit 193 të Kodit Civil...”, neni 34, me ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001”Për krijimin e strukturave për mbrojtjen dhe administrimin e tokës bujqësore” të ndryshuar me ligjin nr. 10 257, datë 25.3.2010 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për Krijimin dhe Funkcionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës", neni 11/1, pika 4, dhe me VKM nr. 661, datë 21.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota që do të transferohen në pronësi të NJQV, Komuna Picar të Qarkut Gjirokastrë” (më tej Komuna i ka dhënë në përdorim e me qira afat 99 vjet me kontratën e Qirasë nr. 1554, datë 5.5.2014, aplikuar për regjistrim nr. 2282, datë 29.7.2015, praktikë e mbetur në proces) (Trajtuar më hollësisht në faqet 184-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Rekomandim 20: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të vendosë masë kufizuese mbi pasurinë nr. 1375, v. 11, f. 86 zk. 2956, **regjistruar zëri kadastral ”kullotë”,** që në fakt sipas VKM nr. 661, datë 21.05.2008 është **zëri kadastral ”pyll”,** me sipërfaqe 33500 m² (3,35 ha), dhe pa shkëputur nga pasuria mëmë prej 26,5 ha, deri në plotësimin e dokumentacionit për marrjen në dorëzim, regjistrimin sipas zërit kadastral “pyll” dhe tërheqjen e certifikatës së lëshuar nr. 606360, datë 2.4.2014 në pronësi të Komunës Picar si dhe për këto veprime të njoftojë Bashkinë Gjirokastrë në juridiksion të së cilës ka kaluar përgjegjësia.

Menjëherë

Gjetje 14: ZVRPP Gjirokastrë, në **4 raste**, ka regjistruar pasuri të përfituara sipas vendimeve të kthimit dhe kompensimit të pronave të ish-pronarëve në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, të ndryshuar dhe rezultoi se pranimi i dokumentacionit dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme është bërë me të meta dhe mangësi analizuar sipas pasqyrës më poshtë:

Pasqyra e pasurive të regjistruar sipas vendimeve të KKK Pronave në ZK 8542

nr	Ref.	Nr. Pas.	Dorëzuar pverbal		Sipërfaqe e regj		Regj tepër	V	faqe	Pronari
			Truall	Ndërt	Truall	Ndërt				
1	2388	7/17	2886	430	3286	430	400	7	104	T.K.
2	1897	7/13	86	86	86	86	-	6	77	F.K.
3	2315	8/162	133.5	133.5	188	188	54.5	7	56-60	N. K.
4	2401	10/34	1842	152	1994	152	152	7	123	Trashëg. C.

Nga auditimi i këtyre praktikave u konstatuan mangësi dokumentare dhe konkretisht:

- Sipas referencës nr. 02388 është aplikuar vetëm për regjistrim të vendimit të KKK Pronave nr. 102/1, datë 20.08.1994, ndërsa për dëshmi trashëgimie nr. 7704, datë 18.10.2010, nr. 3196, datë 27.11.2007, nuk është kërkuar aplikim për regjistrimin e vendimeve të Gjykatave respektive, pra duhej të kërkohejshin përveç tarifës edhe vonesa për regjistrim të aktit normativ në zbatim të nenit 38 të ligjit 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të ndryshuar si dhe regjistrimin e 400 m² truall më tepër pronë publike.

- Sipas referencës nr. 02315 del se janë regjistruar 188 m² truall dhe dyqane nga 133.5 m² të njohur dhe kthyer me vendimin e KK Pronave nr. 32, datë 15.11.1993 dhe dorëzuar me procesverbal nga bashkia Gjirokastrë, pra më tepër 54.5 m².

- Sipas referencës nr. 02401 del se janë regjistruar 152 m² truall më tepër nga sa është dorëzuar me procesverbal, nga grupi i punës i Bashkisë Gjirokastrë.

Për të katër rastet nuk ka urdhër regjistrimi nga regjistruesi si dhe nuk janë verifikuar elementët e formës dhe të përmbajtjes të Aktit administrativ (vendimit të AKKP Gjirokastrë), si dhe nuk janë plotësuar **shtojca 2 e 3**, veprim në papajtueshmëri me nenin 42, pikën 5 nenin 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (Trajtuar më hollësisht në faqet 12- 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 21: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 7/17 truall, volum 7, faqe 104; nr. 8/162 dyqane, volum 7, faqe 59 dhe nr. 10/34 truall, volum 7, faqe 123, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje 15: ZVRPP Gjirokastrë në 2 raste ka kryer regjistrim fillestar të pasurive me dokumentacion në bazë të AMTP-ve sipas ligjit nr. 7501, datë 01.08.1991 “Për Tokën”, në ZK nr. 2392, fshati Lazarat Gjirokastrë, analizuar sipas pasqyrës më poshtë:

nr	Emër mbiemer	REF	ZK	V	faqe	Nr. Pas	Lloji pasur	Sipërfaqja m ² sipas			Data e Certifikata
								AMTP	LN	Dif	
1	M.Gj.	0295	2392	8	122	83/41	Arë	1.144	1.739	595	05.09.2014
2	S.Gj.	0150	2392	12	33	1060	vresht	1.500	2.088	588	24.04.2012
	SHUMA:							2.644	3.827	1.183	

ZVRPP Gjirokastrë ka regjistruar pasuritë e paluajtshme të përfituara me AMTP pa verifikuar elementët e formës dhe përmbajtjes së dokumentacionit tekniko ligjor dhe konkretisht:

- Sipas Referencës nr. 0295, në ZK nr. 2392, Lazarat në emër të M.Gj.

Nuk vërtetohet me dokument ligjor që M. Gj. të ketë pasurinë me nr. 83/44, e llojit arë. AMTP nr. 4705, datë 15.05.1994 në emër të M. Gj. përmban korrigjim sipërfaqesh dhe ka ndryshim të numrit të pasurisë të pa bazuar në dokumente ligjore.

Në lidhje mbi sa më lart mungon në praktikë dokumenti i K/Familjarit të familjes bujqësore.

Nuk ka aplikim, ku të jetë kryer pagesa për shërbimin e regjistrimit të pasurive të regjistruara dhe të certifikuara me nr. 10/42, volum 2, faqe 71, nr. 25/67, volum 4, faqe 211, nr. 26/109, volum 5, faqe 72 dhe nr. 83/40, volum 8, faqe 121, bashkëlidhur referencës 0295, bazuar në tarifat e pagesave llogaritet vlera që duhet të paguante **prej 14,000 lekë**.

- Me Referencë nr. 0150 është regjistruar në KPP, në emër të S.Gj., pasuria nr. 1060, dhe pajisur me certifikatë datë 24.04.2012, në llojin vresht, sipas LN me sipërfaqe 2088 m², nga 1500 m² shënuar sipas AMTP nr. 4883 **e cila mungon dhe nuk ndodhet në arkiv të ZVRPP Gjirokastrë**. Në vijim për këtë pasuri është realizuar kontratë shitje të saj në emër të M.M. pa u bërë ndarja e

sipërfaqes prej 588 m² dhe regjistruar në emër shtet, veprim në kundërshtim me rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën në ZVRPP”.

Për të 2 rastet ZVRPP Gjirokastrë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte Komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, vlefshmërinë ligjore për këto AMTP, veprime në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç” pika 2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi” dhe shkronja “a” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” sipas ligjit nr. 7501, datë 01.08.1991 “Për Tokën” (Trajtuar më hollësisht në faqet 12 -16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 22: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë, për ZK nr. 2392, të kërkojë saktësimin e listave të printim III dhe bërijen e bilancit të pasurive AMTP me LN, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi” dhe konkretisht për pasuritë nr. 83/41 arë, volum 8, faqe 122 dhe pasurinë nr. 1060 veshtë, volum 12, faqe 33.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje 16: ZVRPP Gjirokastrë, në ZK nr. 2392 Lazarat, ka regjistruar në **12 raste**, më tepër sipërfaqen prej **2204 m²**, pasuri të përfituara me listën e trojeve ku u konstatua se janë dhënë më tepër se kjo listë, analizuar sipas pasqyrës si më poshtë:

Tabela e të dhënave të listës së trojeve me 001 në ZK 2392 Lazarat.

Nr	Emër Mbiemër	ZK	Nr. Pasuri	V	Faqe	Sipërfaqja m ²			Data e certifikatës
						Fakt	Sipas listës 01	Difer tepër	
1	V.Ç.	2392	462	9	188	300	114	186	05.05.2011
2	P.Gj.	2392	617	10	94	300	148	152	16.10.2012
3	F. B.	2392	705	10	181	300	72	228	10.08.2014
4	N.S.	2392	713	10	189	300	134	166	17.02.2015
5	Sh. Ç.	2392	471	9	197	300	114	186	16.07.2010
6	A.B.	2392	722	10	198	300	132	168	16.11.2015
7	B.A.	2392	737	10	21	300	144	156	23.04.2007
8	H.A.	2392	740	10	216	300	112	188	02.05.2007
9	B.D.	2392	745	10	221	300	101	199	19.08.2015
10	I.D.	2392	748	10	224	300	141	159	18.07.2014
11	M.B.	2392	976	11	201	300	139	161	16.02.2015
12	N.P.	2392	1175	12	137	300	231	69	24.02.2015

Sipërfaqja totale e dhënë tepër 2204 m²

Në ZVRPP ndodhen dy lista të ardhura nga komuna Lazarat në vitin 2001, njëra e miratuar me 965 troje dhe ndërtesa dhe tjetra me 1071 troje dhe ndërtesa është e pa miratuar, pa firmë dhe vulë të Kryetarit të komunës dhe kryeplakut të fshatit Lazarat,

- Nga Njësia e Menaxhimit të Projektit për 50 raste janë dhënë sipërfaqe më shumë se sa u takonte të merrnin bazuar sipas sipërfaqeve para vitit 1990,

- Në 12 raste nga 50 referenca të audituara janë dhënë certifikata pronësie për një sipërfaqe totale më shumë 2204 m².

Në zbatim të pikës 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, për pasuritë e paluajtshme të fituara në bazë të ligjeve të urbanistikës, në vartësi të viteve dhe të ndarjes administrative qytet/fshat për ndërtimet e kryera para vitit 1990 në fshat, baza ligjore është Dekreti nr. 5747, datë 29.06.1978, neni 10, përcaktohet: “Për

ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore është në “përdorim” një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m².

Përfitimi i sipërfaqes prej 2204 m² nga individ të ndryshëm në 13 raste nuk është rrjedhim i një prej mënyrave të përcaktuara për fitimin e titullit të pronësisë në nenet 162 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i RSH” i ndryshuar.

Me kalimin e sipërfaqes 2204 m² nga shtet në individ në mungesë të titullit legjitim të pronësisë përbën cenim të pronës publike dhe mungesë të ardhurave për këto sipërfaqe (*Trajtuar më hollësisht në faqet 36-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 23: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të kërkojë saktësimin e listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, për ZK nr. 2392, të cilët posedojnë banesa sipas listave 001 dhe deri në saktësimin e gjendjes së pasurive të marrë masa që të mos kryhet asnjë veprim dhe konkretisht për pasuritë nr. 462, volum 9, faqe 188; nr. 617, volum 10, faqe 94; nr. 705, volum 10, faqe 181; nr. 713, volum 10, faqe 189, nr. 471, volum 9, faqe 197; nr. 722, volum 10, faqe 198; nr. 737, volum 10, faqe 21; nr. 740, volum 10, faqe 216; nr. 745, volum 10, faqe 221; nr. 748, volum 10, faqe 224; nr. 976, volum 11, faqe 201; nr. 1175, volum 12, faqe 137; nr. 462, volum 9, faqe 188.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje 17: ZK nr.2989, fshati Plesat, komuna Cepo, Gjirokastrë, në volum 4, faqe 1 regjistruar pasuria 28/5, në zërin kadastral pyll, me sipërfaqe 1000 m² në emër të Komuna Cepo Gjirokastrë dhe është pajisur me certifikatë pronësie, date 02.11.2012,

Gjithashtu në këtë KPP është regjistruar kontrata e shitjes së sipërfaqes pyjore nr. 1911 rep dhe 1179 kol, datë 05.11.2012, në zërin kadastral pyll, në fshatin Plasat Gjirokastrë.

- sipas dokumentacionit që ndodhet në referencat nr. 0018 dhe 0019 ZK nr. 2989, Plasat Gjirokastrë, del se nuk ka urdhër të regjistruesit për regjistrim të pasurisë nr. 28/5, pyll me sipërfaqe 1000 m², në pronësi të komunës Cepo dhe më pas të transaksionit të shitjes.

Veprimet e kryera vijnë në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil dhe ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, veprimet e mësipërme bien ndesh me VKM nr. 748, datë 28.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota , që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Cepo, të Qarkut Gjirokastrë dhe të VKM nr. 244, datë 31.03.2011 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Cepo, të qarkut Gjirokastrë”, të cituar nga komuna për regjistrim dhe më pas shitje, pasi në asnjërin nga këto vendime nuk ka sipërfaqe pyll 1,000 m² që të jetë dhënë kësaj komune (*Trajtuar më hollësisht në faqet 192-194 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 24: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të kërkojë saktësimin e listave të VKM nr. 748, datë 28.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, ish-komuna Cepo, të Qarkut Gjirokastrë” përfshirë këtu dhe pasurinë nr. 28/5, volum 4, faqe 1, në ZK nr. 2989, fshati Plasat Gjirokastrë.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje 18: ZVRPP Gjirokastrë në 5 raste, në ZK nr. 8542 Gjirokastrë dhe nr. 2392 Lazarat Gjirokastrë, ka regjistruar leje ndërtimi me mungesa në dokumentacionin tekniko – ligjor.

Në ZK nr. 8542 në 3 raste në praktikat e regjistruara ka mungesa dhe konkretisht:

Dokumentacioni nuk ka ardhur nga bashkia Gjirokastrë me shkresë përcjellëse për regjistrim; nuk ka projekt dhe preventiv të miratuar për objektin që do të ndërtohet, nuk ka kontratë me subjektin ndërtues apo marrëveshje paraprake ndërtimi midis palëve, nuk ka akte të piketimit të objektit, nuk ka leje shfrytëzimi të lokalit të ndërtuar dhe nuk ka aktkollaudimi, planimetria e sheshit të ndërtimit, pa përshkrim të kondicioneve si dhe dokumentacioni tjetër që individualizojnë ndërtimin e objektit, akt kollaudimi, ku nuk ka asnjë specifikim, pra është formal. Është bërë ndarje pasurie pa patur

urdhër regjistruesi dhe në kundërshtim me vendimin e KRRT-së dhe ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar

Në ZK nr. 2392 Lazarat në dy raste të praktikave të regjistruara mungojnë, vërtetimi degës Tatim Taksave për shlyerjen e detyrimeve të subjektit ndërtues dhe dokumente të tjera që individualizojnë ndërtimin e këtij objekti në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 Për të pesë rastet veprime janë me mospërputhje me nenet 23 dhe 42 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 4 të shtojcën nr. 2 të Udhëzimit të KM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve, që verifikohen nga ZVRPP dhe të procedurës për nxjerrjen e Urdhrit të regjistruetit”, ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 8402, datë 17.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” (Trajtuar më hollësisht në faqet 63- 68 të Projekt Raportit të Auditimit).

Rekomandim 25: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8542 për pasuritë nr. 10/9 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 87, nr. 2/13^{-N+1}, volum 7, faqe 183, nr. 10/104, volum 7, faqe 49-50, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Ndërsa në ZK 2392, pa kufizim të kërkohej plotësimi i dokumentacionit për pasuritë nr. 83/44, volum 8, faqe 122 dhe nr. 3647ND, volum 22, faqe 185.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje 19: ZVRPP Gjirokastër në 12 raste, ka regjistruar leje legalizimi në ZK nr. 8542, qytet Gjirokastër 6 referencia, në ZK nr. 2392 Lazarat 5 referencia dhe ZK nr. 2781 Nepravishtë Gjirokastër 1 rast duke mos verifikuar elementët e përmbajtjes së Aktit Administrativ dhe VKM, mbi bazën e të cilëve janë miratuar parcelat ndërtimore dhe ndërtimet informale.

Pasqyra e regjistrimeve të Leje legalizimi, ZK 8542 qytet, ZK nr. 2392 Lazarat dhe ZK nr. 2781 Nepravishtë

Nr	Emër mbiemer	REF	ZK	V	Fa- qe	Nr. Pas	Sipërfaqja m ²		Vërtetim apo	
							Truall	Ndërt	Nr.	datë
1	A.A.	2193	8542	7	141	16/118	300	140.3	20	16.03.2012
2	M.C	2366	8542	7	94	5/147	300	138	103	16.10.2012
3	A.H.	2399	8542	7	121	17/131	300	124	6	16.01.2013
4	H.Sh.	2503	8542	7	41	24/91	32	76.3	60	13.06.2013
5	A.Gj.	2673	8542	7	186	6/122	212.5	108.6	96	08.10.2013
6	A.L.	2412	8542	7	130	17/33	126.5	126.5	24	21.02.2013
7	B.A.	0375	2392	12	14	1039	540	327.5		09.03.2015
8	Z.B.	0344	2392	12	48	1105	370	120.3		01.04.2015
9	S.G.	0426	2392	11	182	957	500	166.9		21.08.2015
10	I.D.	0391	2392	10	224	748	350	127.8		01.04.2015
11	H.T.	0380	2392	12	76	1114	450	160		17.03.2015
12	E.V.	0063	2781	9	205	2067	512	118		07.07.2015
	Shuma						3993	1732.2		

Për të 12 rastet këto pasuri nuk duhej të ish regjistruar, duhej të ishin refuzuar për sigurimin e dokumentacionit të trajtuar me mungesë si: harta e përditësimit, sipas kufizimeve të parcelës ndërtimore nuk ka rrugë hyrje në objekt, shkresa e Drejtorisë ALUIZNI-t Gjirokastër, ortofoto dixhitale e fotografimit ajror; ndërsa për referencën nr. 2503 mungon kontrata e shitjes së parcelës ndërtimore për 41.6 m², mbasi nga Drejtoria e ALUIZNI-it është trajtuar si pronë e qytetarit por faktikisht kjo pasuri ndodhet e kufizuar sipas rezultateve të kontrollit teknik të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për të cilën janë vendosur kufizimet sipas urdhrit extra datë 14.10.2008 të ish regjistruetit N. D., veprime në papajtueshmëri me pikën 5 neni 44 e neni 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin e Kryeregjistruetit nr. 2532, datë 21.04.2009, Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar sipas

ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informate”(Trajtuar më hollësisht në faqet 63-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 26: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8542 për pasuritë nr. 16/118 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 141, nr. 1/147 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 94, nr. 17/131 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 121, nr. 24/91 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 41, nr. 6/122 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 186, nr. 17/33 truall dhe ndërtesë, volum 7, faqe 130 dhe ZK nr. 2781, pasuria nr. 2067 truall dhe ndërtesë, volum 9, faqe 205, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Ndërsa në ZK 2392, pa kufizim të kërkohej plotësimi i dokumentacionit për pasuritë nr. 1039 truall dhe ndërtesë, volum 12, faqe 14, nr. 1105 truall dhe ndërtesë, volum 12, faqe 48, nr. 957 truall dhe ndërtesë, volum 11, faqe 182, nr. 748 truall dhe ndërtesë, volum 10, faqe 224, nr. 1114 truall dhe ndërtesë, volum 12, faqe 76.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje 20: ZVRPP Gjirokastrë në **31 raste**, ka regjistruar pasuri truall me sipërfaqe **trualli 7560 m²** dhe ndërtesa me sipërfaqe **3089 m²**, të përfituara në bazë të nenit 24/b të ligjit nr. 7843, date 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të ndryshuar në ZK nr. 8542, qytet Gjirokastrë, analizuar sipas pasqyrës si më poshtë:

Pasqyra e pasurive të regjistruar sipas nenit 24/b të ligjit nr. 7843, në ZK 8542

Nr	Ref	Vërtetim hipotek		Lloji Regj	Nr. pas	Sipërfaqja		V	Fa- qe	Pronari
		nr	datë			truall	ndërt			
1	2322	50	09.07.2012	R Fill	21/49	125	125	7	64	A.K.
2	2418	32	07.03.2013	R Fill	19/19	135	90	7	137	K.S.
3	2637	84	05.09.2013	R Fill	12/96	271	144	7	176	I.Ç.
4	2415	26	22.02.2013	R Fill	3/139	115	115	7	134	M.Z.
5	2631	80	30.08.2013	R Fill	18/79	390	114	7	174	A.P.
6	2303	32	25.04.2012	R Fill	3/147	120	89	7	48	Th.Q.
7	2077	s'ka	s'ka	R Fill	17/37	502	103	6	222	B.B.
8	2799	108	27.01.2013	R Fill	2/46	148	87	7	191	A.S.
9	2432	46	24.04.2013	R Fill	7/176	126	112	7	150	M.K.
10	2319	63	02.08.2012	R Fill	4/73	87	73	7	62	H.S.
11	2430	43	17.04.2013	R Fill	2/25	205	123	7	149	V.Q.
12	2654	212	12.01.2012	R Fill	2/197	138	69	7	181	P.Ç.
13	0618	88	18.09.2013	R Fill	2/198	143	75	”	“	G.Ç
14	2380	114	15.12.2012	R Fill	3/93	256	61	7	99	V.Q.
15	2429	51	07.05.2013	R Fill	10/53	88	88	7	148	P.S.
16	2497	53	13.05.2013	R Fill	12/57	125	125	7	157	A.S.
17	2347	76	29.08.2012	R Fill	9/210	128	75	7	79	P.S.
18	2175	3	06.02.2012	R Fill	10/52	123	64	7	30	D.S.
19	2354	81	31.08.2012	R Fill	19/60	271	93	7	84	S.P.
20	2190	15	01.03.2012	R Fill	14/143	106	106	7	40	I.A.
21	2186	43	15.06.2012	R Fill	14/8	119	75	7	38	Ll.B.
22	2382	11	03.12.2012	R Fill	1/22	109	109	7	101	J.Z.
23	2677	s'ka	s'ka	R Fill	2/213	350	150	7	187	S.B.
24	1995	70	20.08.2012	R Fill	2/240	695	160	6	157	P.Zh.
25	2310	47	27.06.2012	R Fill	3/77	440	185	7	54	Th.L.
26	2334	96	04.10.2012	R Fill	25/3	1140	61	7	70	E.S.
27	2406	15	29.01.013	R Fill	3/61	124	86	7	127	F.P.
28	0947	227	09.03.1998	R Fill	3/62	143	79	3	87	K.A.
29	2434	44	22.04.2013	R Fill	13/4	190	112	7	151	P.D.
30	2330	57	27.07.2012	R Fill	17/35	380	40	7	68	A.L.
31	2334	71	21.08.2012	R Fill	17/36	268	101	7	146	N.L.
						7560	3089			

Nga auditimi i këtyre praktikave u konstatuan mangësi dokumentare të përbashkëta si:

- Në të gjitha rastet kërkesat e personave të interesuar nuk janë të regjistruar në protokollin e ZVRPP Gjirokastër, veprim në papajtueshmëri me pikën 4, të VKM nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen” ku përcaktohet: “Regjistrimi i pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në këtë vendim, bëhet me kërkesë të personit të interesuar”.

- Në të gjitha rastet nuk ka vendime të marra nga regjistruesit sipas nenit 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të ndryshuar.

- Në të gjitha rastet mungojnë relacionet për verifikimin në vend të kërkesave qytetare nga grupi i punës, për të cilat duhej të dokumentoheshin me pagesën për këtë qëllim.

- Në të gjitha rastet, regjistrimi fillestar i pasurive duhej të ishte refuzuar për shkak të mungesës së titullit të pronësisë që të vërtetojë pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme në referim të përcaktimeve të nenit 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të ndryshuar dhe VKM nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen.

- Në të gjitha rastet dokumentacioni që ndodhet në dosje nuk është inventarizuar në zbatim të kërkesave të Rregullores nr. 2079, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” nuk janë vendosur numrat kronologjik në të gjitha fletët, veprim në papajtueshmëri me kreun V, të ligjit nr. 9415, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, pikën 2.6, kreu III, të Rregullores nr. 2079, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe Urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 1436, datë 02.11.2010 “Për procedurën e mbajtjes së azhurnuar në mënyrë digjitale të dokumentacionit të ZK që kalojnë regjistrimin fillestar”.

- Në të gjitha rastet nga ZVRPP Gjirokastër, nuk janë verifikuar elementët e formës dhe të përmbajtjes të Akt administrativ, si dhe nuk janë plotësuar **shtojca 2 e 3**, veprim në papajtueshmëri me nenin 42, pikën 5 nenin 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- Në të gjitha rastet nuk disponohen urdhra regjistruesish për kryerjen e regjistrimit.

- Të gjitha rastet e lartpërmendura del se për këto prona nuk kanë dokumentacion të plotë, në lidhje me sipërfaqen e truallit dhe të objektit si dhe nuk kanë qenë të regjistruara më parë, si të tilla veprimet e regjistrimit aktual me dokumentacion të mangët janë në papajtueshmëri me pikën 10 të VKM nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente pronësie të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, apo ndonjë dokument tjetër ligjor në zbatim të nenit 193 të Kodit Civil (*Trajtuar më hollësisht në faqet 126-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 27: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8542 për pasuritë nr. 21/49, volum 7, faqe 64; nr. 19/19, volum 7, faqe 137; nr. 12/96, volum 7, faqe 176; nr. 3/139, volum 7, faqe 134; nr. 18/79, volum 7, faqe 174; nr. 3/147, volum 7, faqe 48; nr. 17/37, volum 6, faqe 222; nr. 2/46, volum 7, faqe 191; nr. 7/176, volum 7, faqe 150; nr. 4/73, volum 7, faqe 62; nr. 2/25, volum 7, faqe 149; nr. 2/197, volum 7, faqe 181; nr. 2/198, volum 7, faqe 181; nr. 3/93, volum 7, faqe 99; nr. 10/53, volum 7, faqe 148; nr. 12/57, volum 7, faqe 157; nr. 9/210, volum 7, faqe 79; nr. 10/52, volum 7, faqe 30; nr. 19/60, volum 7, faqe 84; nr. 14/143, volum 7, faqe 40; nr. 14/8, volum 7, faqe 38; nr. 1/22, volum 7, faqe 101; nr. 2/213, volum 7, faqe 187; nr. 2/240, volum 6, faqe 157; nr. 3/77, volum 7, faqe 54; nr. 25/3, volum 7, faqe 70; nr. 3/61, volum 7,

faqe 127; nr. 3/62, volum 3, faqe 87; nr. 13/4, volum 7, faqe 151; nr. 17/35, volum 7, faqe 68; nr. 17/36, volum 7, faqe 146, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje 20: Në KLSH me prot. nr. 74, datë 18.01.2016 ka paraqitur ankesa znj. L. I., në lidhje me mos regjistrimin nga ZVRPP Gjirokastrë të pasurisë nr. 10/58, në ZK 8542 qyteti Gjirokastrë.

Nga verifikimi i dokumentacionit del se kërkesa e bërë për regjistrim të vendimit të gjykatës nr. 587, datë 16.11.2015 me një sipërfaqe trualli 1585.5 m² dhe 215 m² banesë rezulton se ky vendim është apeluar në Gjykatën e Apelit nga ZVRPP Gjirokastrë.

Nga ZVRPP Gjirokastrë nuk është bërë azhurnimi i saktë i hartës së punës për pasuritë e regjistruara, për rrjedhojë nga verifikimi i dokumentacionit dhe azhurnimi i hartës së punës të ZVRPP del se në periudhat e mëparshme në këtë sipërfaqe të kërkuar janë regjistruar prona me pronar të ndryshëm dhe konkretisht .

Me **referencë nr. 1252** është regjistruar në hipotekë pasuria nr. 50/57 me sipërfaqe 475 m², mbi të cilën është ngritur një shtëpi 2 dhe 3 kate, banesa ka çati të përbashkët me S. Ç. dhe ndodhet në lagjen “Partizani” të qytetit Gjirokastrë në emër të I.F.L.

Me **referencë nr. 1157** është regjistruar pasuria nr. 10/58 me sipërfaqe trualli 251 m², mbi të cilën është ngritur një shtëpi banimi 2 dhe 3 kate me sipërfaqe 114 m², ndodhur në lagjen “Partizani”, qyteti Gjirokastrë, me pronar S.D. me 6/7 pjesë dhe Q.S.D. me 1/7 pjesë sipas dokumentacionit që ka shërbyer për regjistrimin e kësaj pasurie.

Në të dy rastet regjistrimi është bërë me dokumentacion me mangësi, veprime në papajtueshmëri me pikën 10, të VKM nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”.

Si rezultat i këtyre veprimeve del se brenda sipërfaqes së kërkuar dhe pikërisht në pjesën takuese të kërkuases znj. L. I. rezulton prona me mbivendosje për sipërfaqen prej 826 m², gjë që nuk është e konstatuar nga specialistët e ZVRPP Gjirokastrë, veprimet e konstatuara vijnë në kundërshtim me nenin 28, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimit të KM nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Në përfundim kërkesa e znj. L. I. nuk është objekt i gjykimit administrativ, por mbetet në çmim dhe vlerësim të gjykatës, meqenëse aktualisht kjo çështje është në gjykim në shkallë më të lartë Gjykatë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk ndërhyr në të tilla raste deri në përfundimin e hetimit gjyqësor, por ankuesja do të bëhet me dije për mbivendosjen e konstatuar prej 826 m² me dokumentacion me mangësi përfituar nga I.S. dhe S.D., veprim në papajtueshmëri me pikën 10, të VKM nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, e cila këto fakte t’i paraqesë në gjykatë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 176-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 28: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdher kufizimi në ZK nr. 8542 për pasurive nr. 50/57 në emër të I.L. dhe nr. 10/58 në emër të S.D. gjithashtu për rastin e mbivendosjes së krijuar me sipërfaqe prej 826 m² në pronë të kërkuases znj. L.I., të përgatitet dokumentacioni në zbatim të Udhëzimit të KM nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje 21: Volumet e Kartelave të Pasurive të Paluajtshme janë të palidhura sipas kushtit të plotësimit me 250 fletë për çdo volum, në total janë 65 volume të palidhura përkatësisht 23 volume të zonës kadastrale Lazarat, 21 volume të zonës kadastrale 8541, 6 volume të zonës kadastrale 8542, 5 volume të zonës 8543, 10 volume të Libohovës *(të palidhura dhe në proces të papërfunduar të menaxhimit që nga viti 2013)*, gjendje në kundërshtim e Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” *(Trajtuar më hollësisht në faqe 194-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 29: Nga ZVRPP Gjyrokastër të merren masa të menjëhershme për lidhjen dhe administrimin e volume të kartelave të pasurive, masa të cilat do ti shërbejnë mbarëvajtjes së procesit të regjistrimit të pasurive si dhe ruajtjen e të dhënave në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Menjëherë

Gjetje 22: Nga auditimi u konstatua se mungojnë listat printim III me kryefamiljarë në formë të shkruar dhe digjitale, pothuajse në të gjitha zonat kadastrale, gjë që sjellë vështirësi në bërjen e bilancit të pasurive me AMTP dhe LN, si dhe vështirësi në zbatimin e VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”. Mungojnë inventarët e AMTP-ve të marra në dorëzim nga organet e tjera shtetërore sipas VKM nr. 556, datë 23.10.2000 “Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Mungojnë fizikisht AMTP për fshatin Mashkullorë dhe Valare dhe nuk jepet informacion nëse janë dorëzuar nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve ose jo *(Trajtuar më hollësisht në faqe 194-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 30: Nga ZVRPP Gjyrokastër në bashkëpunim me ZQRPP të merren masa të menjëhershme për administrimin e listave printim III me kryefamiljarë për zonat kadastrale që mungojnë, të përpilohen inventarët e AMTP-ve të marra në dorëzim, si dhe administrohen fizikisht AMTP për zonat të cilat mungojnë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 556, datë 23.10.2000 “Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Menjëherë

Gjetje 23: Të gjitha materialet e arkivuara në arkiva nuk janë dorëzuar dhe marrë në dorëzim nga specialistët e Arkivës sipas periudhave të ndryshme, gjithashtu nuk është bërë inventarizimi i arkivës. Mungonin procesverbalet e marrjes dhe dorëzimit të detyrës, si dhe dokumentacionit nga secili prej ish-Regjistruesve. Shumica e veprimeve fillestare me pasuritë janë kryer pa referenca. Ka kushte të pamjaftueshme ambientesh dhe zyrash pune, sidomos zyra për arkivin dhe depozitimin e ruajtjen e dokumentacionit *(Trajtuar më hollësisht në faqe 194-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 31: Nga ana e ZVRPP Gjyrokastër të merren masa që në çdo rast të lëvizjes së punonjësve të bëhet dorëzimi dhe marrja e detyrës me procesverbal, të bëhet inventarizimi i menjëhershëm i arkivës së institucionit si dhe të gjitha veprimet me pasuritë të shoqërohen me referenca përkatëse, të gjitha këto masa në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregulloren e ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme” të ndryshuar, Rregulloren nr. 2079, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në ZVRPP”.

Në vazhdimësi

Rekomandim 32: Nga ana e ZQRPP-së të merren masa të menjëhershme për krijimin ambienteve dhe kushteve të mjaftueshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe ecurinë normale të procesit të regjistrimit të pasurive nga ZVRPP Gjirokastrë, si dhe ruajtjen e administrimit e dokumentacionit në mënyrë të sigurt (*dokumente që kanë afat ruajtje të përjetshme*) në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 2079, datë 11.6.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko-ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Menjëherë

Gjetje 24: Nga auditimi rezultoi se zonat kadastrale Kaparel, Fushe Bardh, Zhulat, Taroninë, Tranoshisht dhe Drino, nuk janë në sistem dhe nga zyra nuk disponohet asnjë dokument si listë printime, hartë treguese dhe volume. Zona kadastrale 2444 Libohovë është ende në proces, janë çelur vetëm kartela sporadike, nuk janë kryer veprime dhe nuk janë lëshuar certifikata. Procesi për menaxhimin dhe hedhjen e kësaj zone në sistem ka filluar me urdhrin Nr. 1008, datë 15.10.2012 të Regjistruesit Dh.K. dhe deri në datë 04.02.2016 ende nuk ka përfunduar. Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se një pjesë e hartave të zonave janë të dëmtuara dhe mbi ti nuk mund të punohet, janë të papërdorshme (*Trajtuar më hollësisht në faqe 194-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 33: Nga ZVRPP Gjirokastrë në bashkëpunim me ZQRPP të merren masa për përfundimin e procesit të hedhjes së zonave në sistem, administrimit e dokumentacionit si listë printime, hartë treguese dhe volume si dhe zëvendësimin e menjëhershëm të hartave të dëmtuara të zonave kadastrale.

Deri datë 30.9.2016

Gjetje 25: Në 5 raste nga ish-Komuna Lunxhëri janë lidhur kontrata qiraje me afate nga 1 vit deri në 99 vjet, për sipërfaqen totale 63.047 Ha për të cilat nuk është bërë aplikimi për regjistrim në ZVRPP, nuk ka asnjë të dhënë që të vërtetojë pronësinë e Komunës Lunxhëri mbi këto pasuri, pra nuk ka tituj pronësie, gjithashtu nuk evidentohet me evidenca nga kjo Komunë për këtë fshat për gjendjen e tokave të pandara, por dhe ky fakt nuk i shërben Komunës për të lidhur kontrata qiraje pa tituj pronësie veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 33 datë 21.3 2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 180-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 34: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa që në rast të paraqitjes për regjistrim të kontratave si më poshtë:

- 1 - Kontrata e qirasë datë 26.02.2013, me qiramarrës z. A.F.C., sipërfaqe 1.185 ha tokë bujqësore, afati 99 vjet,
- 2 - Kontrata e qirasë datë 15.01.2012, me qiramarrës z. N.C., sipërfaqe 0.932 ha tokë bujqësore, afati 99 vjet,
- 3 - Kontrata e qirasë datë 26.09.2011, me qiramarrës shoqëria “U. Gj.” Sh. p. k, përfaqësuar nga z. P. D. S., sipërfaqe 8.6 ha tokë bujqësore, afati 10 vjet,
- 4 - Kontrata e qirasë datë 27.05.2013, me qiramarrës shoqëria “Y. M” me Nipt: Lxxxxxxx B, sipërfaqe **6.75 ha** tokë bujqësore, afati 99 vjet, si dhe kontratave të tjera të cilat kanë të njëjtën problematikë me kontratat e mësipërme të refuzojë regjistrimin e tyre pasi qiradhënësi nuk zotëron tituj pronësie mbi sipërfaqet që do të jepen me qira.

Menjëherë

Gjetje 26: Në AMTP-të e përcjella për regjistrim nga Këshilli i Qarkut me shkresën nr. 383 prot, datë, 08.12.2015, në zbatim të Vendimit të Gjykatës, nr. 492, Regj nr. 464, datë 17.09.2015, janë konstatuar mangësi pasi nga 23 persona paditës që janë përmendur në vendimin e gjykatës, vetëm 22 AMTP janë përcjellë në ZVRPP-Gjirokastrë, mungon AMTP për shtetasen A.N. dhe në 3 prej AMTP-ve përkatësisht me numra 6003, 6016, 6019 ka mospërputhje të emrave sipas Vendimit të

Gjykatës dhe atyre të përcaktuara në AMTP (*Trajtuar më hollësisht në faqe 180-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Rekomandim 35: Nga ZVRPP Gjirokastrë t'i kërkohet Këshillit të Qarkut Gjirokastrë plotësimi i AMTP-ve me të dhëna të sakta në përputhje me Vendimin e Gjykatës Nr. 464, datë 17.09.2015 si dhe certifikatave të gjendjes civile të personave që i posedojnë ato si dhe përcjellja me shpresë e AMTP-së që mungon.

Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për vendosjen e kufizimit për pasuritë të cilat janë regjistruar me AMTP dhe të cilat kanë mospërputhje me vendimin e Gjykatës deri në saktësimin e të dhënave.

Menjëherë

Gjetje 27: Me ref. 424, datë 14.07.2014 është regjistruar pasuria nr. 90/1, vol. 6, fq. 242, zk. 3701/Valare, me sip. 14000 m², e llojit arë, në pronësi të P. B.M, në bazë të shkresës të Komunës Lunxhëri nr. 241, datë 16.12.2013, në të cilën citohet se shtetasi P. M. ka fituar të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen prej 14000 m² sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë nr. 390, datë 25.04.2013, por në dosje nuk administrohet Vendimi Gjykatës në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 33, datë 21.3 2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimit të KM, nr. 2, datë 12.9.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, pika 3. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 36: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për të vendosur kufizimin mbi pasurinë nr. 90/1, vol. 6, fq. 242, zk. 3701/Valare në pronësi të P.B.M. deri në përcjelljen e Vendimit të Gjykatës mbi bazën e të cilit ka fituar pronësinë mbi pasurinë në fjalë.

Menjëherë

Rekomandim 37: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa që në çdo rast të paraqitjes për regjistrim të akteve administrative, akteve noteriale dhe vendimeve të gjykatave të plotësohen shtojcat përkatëse në zbatim të Udhëzimit të KM, nr. 2, datë 12.9.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 28: Veprimet për ndarjen pasurisë nr. 57/5, vol 4, fq. 17, zk. 3701/Valare me sipërfaqe 56850 m², në pronësi shtet, nuk janë të rregullta pasi fillimisht duhet të nxirrej urdhri për mbylljen e kartelës së pasurisë mëmë dhe hapjen e dy kartelave të reja njëra me sipërfaqen mbi të cilën do të regjistrohet AMTP-ja dhe tjetra me sipërfaqen që mbetet në shtet. Mosveprimet e mos pasqyrimi i veprimeve të ndarjes në KPP pa çelur KPP-të përkatëse, pa shënimin e referencës për ndryshimet e bëra vijnë në kundërshtim me nenin 34 dhe 35 të ligjit nr. 33 datë 21.3 2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe me Kreun e VI “Trajtimi i Pasurive të Paluajtshme pas Regjistrimit Fillestar”, pika 5 “Regjistrime të ndryshimeve në KPP”, pika 5.1 “Regjistrime që sjellin ndryshime në Seksionin A, B, dhe C të Kartelës”, “Ndarja e pasurisë”, të Rregullores nr. 184, datë 18.4.1999 “Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, si dhe Udhëzim metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 38: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për të mbyllur KPP pasurisë mëmë 57/5, vol 4, fq. 17, zk. 3701/Valare, e llojit arë, me sipërfaqe 56850 m² dhe hapjen e një karteje të re të pasurisë për sipërfaqen e ngelur 50700 m².

Menjëherë

Gjetje 29: Nga krahasimi i emrave të “Listës emërore të specialistëve që marrin tokën në përdorim”, hartuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit me përfaqësues z.J.R dhe Agjencia e Privatizimit me përfaqësues N. A., e cila mbyllet me numër rendor 170, me emrat e personave në cilësinë e paditësve në Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, Nr. 492,

Regj Nr. 464, datë 17.09.2015, rezulton se vetëm 5 prej personave paditës që përmenden në vendim janë dhe në listën emërore të personave që marrim tokën në përdorim, ndërsa pjesa tjetër prej 18 personash të përmendur në vendim nuk janë në këtë listë. Emrat e këtyre personave nuk gjenden as në Listën Printim III sipas kryefamiljarëve e administruar në ZVRPP-Gjirokastrë, listë e cila nuk është e plotë, si dhe as në Listën Rendore të Pronarëve (*Trajtuar më hollësisht në faqe 180-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 39: ZQRPP dhe ZVRPP Gjirokastrë të kërkojnë pranë Ministrisë Drejtësisë që nëpërmjet strukturave të shqyrtojë Vendimin e Gjykatës nr. 464, datë 17.09.2015, për bazueshmërinë ligjore të trajtimit me tokë të disa personave, për shkak të kufizimit ligjor të trajtimit nga KLSH të çështjes, sepse ka kaluar zgjidhja e çështjes në rrugë administrative nga KLSH dhe tashmë i është nënshtruar rrugës gjyqësore. Opinioni i KLSH në lidhje me këtë është i pamundur të jepet pasi rruga fundore është çuarja në Gjykatë.

Menjëherë

Gjetje 30: Në zonën kadastrale 2392, Lazarat janë regjistruar sipas listës 0001 “*Lista emërore e pronave të trojeve dhe të shtëpive*”, 25 pasuri të llojit truall pa dokumentacion shtesë apo referencë që ka shërbyer për regjistrim. Gjithashtu nga verifikimi në KPP i këtyre pasurive rezultoi se ishte **regjistruar tepër sipërfaqe truall 2102 m² në total, për 11 pasuri**, pasi nuk përputhen me sipërfaqet truall të përcaktuara në listën 0001 “*Lista emërore e pronave të trojeve dhe të shtëpive*”, e përcjellë në ZVRPP për regjistrimin e këtyre pasurive. Regjistrimi i pasurive pa referenca dhe në mënyrë ekstra pa asnjë dokumentacion vjen në kundërshtim me kërkesat e Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 40-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 40: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa që në çdo rast të regjistrimit të pasurive sipas listave të trojeve dhe shtëpive të kërkohet dokumentacioni shtesë si Certifikatë familjare e datës 01.08.1991, vërtetim për gjendjen familjare sipas certifikatës, vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore, Aplikimi, mandat pagesa si dhe Plan Rilevimi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Rekomandim 41: Nga ana e ZVRPP Gjirokastrë të kërkohet saktësimi i listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, të cilët posedojnë banesa sipas listave 0001, dhe deri në saktësimin e gjendjes së pasurive të marr masa që të mos kryhet asnjë veprim në pasuritë si vijon: - Pasuria nr. 2580, vol 17, fq. 244, zk. 2392; Pasuria nr. 3032, vol 19, fq. 195, zk. 2392; Pasuria nr. 3026, vol. 19, fq. 189, zk. 2392; Pasuria nr. 2960, vol 19, fq. 123, zk. 2392; Pasuria nr. 2882, vol. 19, fq. 45, zk. 2392; Pasuria nr. 2885, vol 19, fq. 48, zk. 2392; Pasuria nr. 2942, vol 19, fq. 105, zk. 2392; Pasuria nr. 3213, vol 20, fq. 125, zk. 2392 ; Pasuria nr. 3296, vol 20, fq. 208, zk. 2392 ; Pasuria nr. 3339, vol 21, fq. 1, zk. 2392; Pasuria nr. 3400, vol 21, fq. 62, zk. 2392.

Menjëherë

Gjetje 31: Në 7 raste edhe pse sipërfaqet truall të regjistruara në KPP nuk përputheshin me sipërfaqet e përcaktuara sipas listës 0001 “*Lista emërore e pronave të trojeve dhe të shtëpive*”, dokument i vetëm mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi i këtyre pasurive, me këto pasuri janë kryer transaksione pa kryer verifikimet e nevojshme për gjendjen e pasurisë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 40-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 42: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa që në çdo rast të regjistrimit të pasurive sipas listave të trojeve dhe shtëpive, përpara se të kryen transaksione me to të verifikohet gjendja e pasurisë, nëse sipërfaqja sipas listave të trojeve përputhen me sipërfaqen e regjistruar në kartelat e pasurive.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 32: Në 7 raste nga verifikimi i listës 0001 “Lista emërore e pronave të trojeve dhe të shtëpive” dhe regjistrimeve të bëra në volumet 17-23, zk. 2392, rezultoi se 7 persona kishin marrë më shumë se dy prona të trojeve apo shtëpive, kjo pa u shoqëruar me dokumentacion tjetër justifikues dhe aq me tepër kur lista e trojeve është e vitit 2001, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 date 29.06.1978 dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”(Trajtuar më hollësisht në faqe 40-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 43: Nga ZVRPP Gjirokastër të kërkohej saktësimi i listave të kryefamiljarëve, gjendje e vitit 1991, të cilët posedojnë banesa sipas listave 0001 dhe deri në saktësimin e gjendjes së pasurive të marr masa që të mos kryhet asnjë veprim në pasuritë si vijon: - Pasuria 84/27, vol. 8, fq. 160, zk. 2392; Pasuria 84/2, vol. 8, fq. 137, zk. 2392; Pasuria 84/3, vol. 8, fq. 138, zk. 2392; Pasuria 84/29, vol. 8, fq. 162, zk. 2392; Pasuria 84/89, vol. 8, fq. 222, zk. 2392; Pasuria 84/28, vol. 8, fq. 161, zk. 2392; Pasuria 1312, vol. 13, fq. 24, zk. 2392; Pasuria 979, vol. 11, fq. 204, zk. 2392; Pasuria 2113, vol. 16, fq. 32, zk. 2392; Pasuria 2886, vol. 19, fq. 49, zk. 2392; Pasuria 2889, vol. 19, fq. 52, zk. 2392; Pasuria 3036, vol. 19, fq. 199, zk. 2392; Pasuria 3329, vol. 20, fq. 241, zk. 2392

- Të lihen të lira vetëm njëra nga pasuritë për çdo person dhe konkretisht pasuria 2484, vol. 17 , fq. 148, zk. 2392; pasuria 2470, vol. 17 , fq. 134, zk. 2392; pasuria 2684, vol. 18, fq. 98, zk. 2392; pasuria 2211, vol. 16, fq. 130, zk. 2392, për të cilat nuk është kërkuar të mos kryhen veprime si më sipër, pasi nuk janë konstatuar diferenca në sipërfaqe nga ajo e përcaktuar në listën e trojeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 33: Në regjistrimin e pasurisë 2410, vol. 17, fq. 74, zk. 2392-Lazarat, me sipërfaqe 1258 m², në emër të P.N.Gj. është konstatuar ndryshimi i zërit kadastral nga tokë “arë” në “vresht” në kundërshtim me AMTP nr. 4723, formularin 6, ndryshim ky i pajustificuar me dokumentacion apo procedurë për ndryshimin e zërit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, Ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 40-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 44: Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për kufizimin e pasurisë nr. 2410, vol. 17, fq. 74, zk. 2392-Lazarat, deri në dorëzimin e dokumentacionit i cili justifikon ndryshimin e zërit kadastral në përputhje me kërkesat ligjore.

Menjëherë

Gjetje 34: Na bazë të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër Nr. 1414, datë 11.09.1996, është vendosur të njohë bashkëpronësinë në pjesë të barabartë të trashëgimtarëve të A.dhe Sh. K. në Kullotën Corolengo 120 ha, në kullotën Korëz 130 ha kullotë dhe 15 ha pyll, në kullotën Liqeth 130 ha, në Kullotën Karan 110 ha dhe në kullotën Zeko 25 ha.

Ndërkohë sipas Vendimit Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Gjirokastër nr. 4, datë 02.10.1996, ka vendosur **t’i kthejë trashëgimtarëve të Sh. dhe A. K. sipërfaqen prej 540 ha** në vendet e quajtura Korëz 130 ha me numër pasurie 9, në Corolengo 105 ha me nr parcele nr. 20, Liqeth 120 ha me nr. Pasurie 53, Kora (Topovë)160 ha me Nr. Parcela 48, në Zeko (Lunxhëri) 25 ha me numër parcelë ekstra. Nga verifikimi i regjistrimeve të kryera për zbatimin e Vendimit të KKKP-së rezultoi se është regjistruar sipërfaqja prej 550.03 ha, në kundërshtim me vetë Vendimin e KKKP-së ku kthehet sipërfaqja 540 ha, **pra 10,03 ha ose 100300 m² më tepër pronë shtetërore e përfituar padrejtësisht nga privati**, veprime këto në kundërshtim me ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, Neni 25-Mënyra e regjistrimit fillestar, Ligjin Nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të

paluajtshme”, pika 10, si dhe me Vendimin KKKP-Gjirokastrë nr. 4, datë 02.10.1996. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 18-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 45: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për kufizimin e pasurisë 646/27, vol. 4, fq. 230, me sipërfaqe 10.1 ha Kullotë, zk. 2094/Karjan, regjistrim i fundit sipas ref nr. 035, pa datë, dhe sipërfaqe që mbulon diferencën e regjistruar tepër prej 10,03 ha, e cila duhet të kthehet në pronësi shtet, si dhe të kërkohet shfuqizim i certifikatës së pronësisë datë 29.01.2013 të lëshuar me tituj ta paligjshëm pronësie.

Menjëherë

Gjetje 35: Nga regjistrimet e kryera në kartelat e pasurive për zbatimin Vendimit të KKKP-Gjirokastrë nr. 4, datë 02.10.1996, për trashëgimtarët e Sh. dhe A. K., rezulton se është ndryshuar **zëri kadastral nga arë në kullotë, për sipërfaqen totale prej 185400 m²**, pa u shoqëruar me dokumentacion apo procedurën që justifikon ndryshimin e zërit kadastral nga tokë “arë” në “kullotë”, veprime këto në kundërshtim me ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës” dhe ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” *(Trajtuar më hollësisht në faqe 18-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 46: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për kufizimin e pasurive deri në dorëzimin e dokumentacionit i cili justifikon ndryshimin e zërit kadastral në përputhje me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, si më poshtë:

- Pasuria 646/27, vol.4, fq. 230, zk. 2094/Karjan
- Pasuria 1110, vol. 4, fq. 130, zk. 2032/Kakoz

Menjëherë

Gjetje 36: Në zonën kadastrale 3907-Zervat nga regjistrimin e pasurive me AMTP, rezultoi se në **67 raste** nuk janë veçuar dhe regjistruar shtet sipërfaqja tepër **9233 m²**, ku nuk janë kryer veprime në KPP, ndërsa në **22 raste me sipërfaqe 2276 m²**, ku janë kryer veprime, si regjistrim dëshmie trashëgimie, lëshim certifikate pronësie, kontrata shitje, ndarje pasurie, pasi sipërfaqja e përcaktuar në AMTP është më e vogël se ajo e përcaktuar në Librin e Ngatrave. Këto veprime bien në kundërshtim me sipërfaqen e përcaktuar në AMTP, ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” si dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, Rregulloren nr. 76, datë Udhëzim metodik Nr. 76 Prot, Date 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme” *(Trajtuar më hollësisht në faqe 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Rekomandim 47: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për të vendosur kufizimin mbi pasuritë mbi të cilat janë kryer transaksione sipas tabelës nr. 2, emërtuar “KPP me sipërfaqe tepër AMTP-LN, por që janë kryer veprime në zk. 3907” bashkëlidhur Raportit, *(por jo mbi ato të pasuri që janë tjetërsuar tek persona të tretë, 4 raste)* deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe veçimin në shtet të sipërfaqes që rezulton tepër sipas LN. Gjithashtu të merren masa që në pasuritë mbi të cilat nuk janë kryer veprime sipas tabelës nr. 1 emërtuar “KPP me sipërfaqe tepër AMTP-LN, por që janë nuk janë kryer veprime në zk. 3907” bashkëlidhur Raportit, të mos kryen transaksione në vazhdim deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe veçimin në shtet të sipërfaqes së tepërt.

Menjëherë

Gjetje 37: Në 6 raste nga regjistrimet e pasurive me AMTP në zk. 3907 Zervat rezulton se është ndryshuar **zëri kadastral nga pemëtore në tokë arë dhe nga tokë arë në vresht, për sipërfaqen totale prej 4542 m²**, pa u shoqëruar me asnjë dokumentacion apo procedurën që justifikon ndryshimin e zërit kadastral, veprime këto në kundërshtim me ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës” dhe ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” *(Trajtuar më hollësisht në faqe 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 48: Nga ZVRPP Gjirrokastër të merren masa për kufizimin e pasurive në përputhje me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, deri në dorëzimin e dokumentacionit i cili justifikon ndryshimin e zërit kadastral si vijon: - Pasuria 2410, vol. 17, fq. 74, zk. 3907; Pasuria 71/53, vol. 4, fq. 207, zk. 3907; Pasuria 70/81, vol 4, fq. 99, zk. 3907; Pasuria 71/90, vol. 4, fq. 248, zk. 3907; Pasuria 71/84, vol 4, fq. 242, zk. 3907; Pasuria 71/83, vol 4, fq. 241, zk. 3907; Pasuria 70/58, vol 4, fq. 76, zk. 3907.

Menjëherë

Gjetje 38: Në zonën kadastrale 3701-Valare nga regjistrimi i pasurive me AMTP, rezultoi se në **109 raste** nuk janë veçuar dhe regjistruar shtet sipërfaqja **52849 m²**, ku nuk janë kryer veprime në KPP, në **110 raste** sipërfaqja **20503 m²**, ku janë kryer veprime, si regjistrim dëshmie trashëgimie, lëshim certifikate pronësie, kontrata shitje, ndarje pasurie, pasi sipërfaqja e përcaktuar në AMTP është më e vogël se ajo e përcaktuar në Librin e Ngastrave, ndërsa **në 103 raste** ku sipërfaqja e përcaktuar në AMTP është më e madhe se ajo e përcaktuar në Librin e Ngastrave, **me sipërfaqe totale 18823 m² tepër**, por që nuk janë kryer veprime në KPP. Këto veprime bien në kundërshtim me sipërfaqen e përcaktuar në AMTP, ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” si dhe sipas periudhave Ligjin nr. 7843 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, dhe Rregulloren nr. 76, datë Udhëzim metodik Nr. 76 Prot, Date 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”(Trajtuar më hollësisht në faqe 47-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim 49: Nga ana e ZVRPP Gjirrokastër të merren masa për të vendosur kufizimin mbi pasuritë mbi të cilat janë kryer transaksione sipas tabelës nr. 2, emërtuar “KPP me sipërfaqe tepër AMTP-LN dhe LN-AMTP, por që janë kryer veprime në zk. 3701” bashkëlidhur Projekt Raportit, (por jo mbi ato të pasuri që janë tjetërsuar tek persona të tretë pra janë shitur) deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe veçimin në shtet të sipërfaqes **20503 m²** që rezulton tepër sipas LN. Gjithashtu të merren masa që në pasuritë mbi të cilat nuk janë kryer veprime sipas tabelës nr. 1 emërtuar “KPP me sipërfaqe tepër AMTP-LN dhe LN-AMTP, por që nuk janë kryer veprime në zk. 3701” bashkëlidhur Projekt Raportit, të mos kryen transaksione në vazhdim deri në bërjen e bilancit të pasurive dhe veçimin në shtet të sipërfaqes së tepërt prej **52849 m²**, ndërsa në rastin kur sipërfaqe e AMTP-së është më e madhe se LN, në momentin që do të aplikohet për lëshim certifikatë pronësie apo transaksione të tjera, duhet të kërkohet deklarata noteriale për heqje dorë nga sipërfaqja e tepërt.

Menjëherë

Gjetje 39: Në mbajtjen, plotësimin dhe regjistrimin e veprimeve në kartelave të pasurive janë konstatuar një sërë mangësish si: fletë boshe të paplotësuara, pa datë përfundimtare, pa plotësuar rubrikën se ku shkon pasuria si dhe numri i referencës me të cilën transferohet, në disa raste kartelat janë mbyllur pa vulë dhe firmë nga Regjistruesi, në disa raste nuk është përcaktuar lloji i pasurisë, në disa raste nuk është plotësuar emri i pronarit, mangësi të cilat vinë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit metodik nr.76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”(Trajtuar më hollësisht në faqe 47-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 50. Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirrokastër, të merren masat në mënyrë që kartelat e pasurive të paluajtshme të nënshkruhen nga punonjësi që kryen veprimet në kartelë, të plotësohet data përfundimtare, të mbyllen kartelat, si dhe të përcaktohet në cilin volum dhe faqe vijojnë pasuritë e ndara, lloji i pasurisë, si dhe të mos kryhen më veprime në kartela të pasurive të paluajtshme, me urdhër të panëshkruar dhe të pavulosur, nga Regjistruesi, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 40: Për pasurinë nr. 108/16, vol. 2, fq 61, zk. 3535, Suhe, e llojit truall regjistruar sipas listës 0001 “*Lista emërore e pronave të trojeve dhe të shtëpive*”, me 300 m² truall dhe 136 m² ndërtesë në pronësi të P.M.Xh. lëshuar certifikatë pronësie datë 26.02.2013 po me këto sipërfaqe, rezultoi se me Ref. 032, është shtuar sipërfaqja e ndërtimit për objektin nga 136 m² në 236 m², vetëm me anë të një HTR dhe pa asnjë dokumentacion tjetër vërtetues e justifikues, pa urdhër të regjistruesit për kryerjen e veprimit në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, neni 48, Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”(Trajtuar më hollësisht në faqe 40-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 51: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, të merren masat për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit mbi pasurinë nr. 108/16, vol. 2, fq 61, zk. 3535, Suhe në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në plotësimin e dokumentacionin tekniko-ligjor që justifikon ndryshimet në sipërfaqe.

Menjëherë

Gjetje 41: Regjistrimi i Vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 118, datë 30.04.1999 me referencën nr. 025 nga ZVRPP-Gjirokastër në parcelën nr. 53/1, e cila referuar hartës përkatëse është argjinaturë e lumit Drino, pra është shtrat lumi dhe është në kundërshtim me ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat ujore”, neni 3, pasi e drejta e pronësisë së shtetit është e patjetërsueshme dhe pa parashkrueshme si dhe me Ligjin nr. 7843, 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”. Ndërkohë që me Vendimin e Gjykatës Nr. 23-2015-232(100), datë 13.02.2015 për anulimin e pjesshëm të Vendimit të Komisionit nr. 118, datë 30.04.1999, është korrigjuar pasoja më sipër si dhe ka bërë ndryshimet duke kompensuar në natyrë sipërfaqen prej 2,7 ha në pasurinë nr. 94/2, e ndryshme nga pasuria 53/1 e përcaktuar në Vendimin e Komisionit që ishte shtrat lumi, por nga ana e ZVRPP nuk është fshirë regjistrimi fillestarë në regjistrin hipotekor nr. 4, datë 18.04.2006, zona kadastrale Topullarë (Trajtuar më hollësisht në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 52 Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për fshirjen e regjistrimit fillestar në regjistrin hipotekor nr. 4, datë 18.04.2006, zona kadastrale Topullarë, pasuria 53/1, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Menjëherë

Gjetje 42: Në pjesën përfundimtare të Vendimit të Gjykatës Nr. 23-2015-232(100), datë 13.02.2015 për anulimin e pjesshëm të Vendimit të Komisionit nr. 118, datë 30.04.1999, nuk është përcaktuar nëse sipërfaqja që do të kompensohet në natyrë prej 2,7 ha është tokë arë, pyll, pemëtore apo kullotë, pra nuk është përcaktuar zëri kadastral. Ndërkohë që nga verifikimi i hartave të zonës përkatëse, konkretisht parcelës nr. 94 rezulton se pasuritë në të, janë toka arë, për pasojë dhe regjistrimi në KPP i sipërfaqes prej 27000 m² me numër pasurie 94/2, vol. 7, fq. 41, zk. 3701 sipas zërit kadastral kullotë është i gabuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 53: Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit mbi pasurinë 94/2, vol. 7, fq. 41, zk. 3701-Valare, në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në dorëzimin e Aktit Fillestar të Ekspertimit të përmendur në Vendimin e Gjykatës si dhe të bëhet korrigjimi i zërit kadastral në përputhje me Aktet e ekspertimit dhe hartat e zonave.

Menjëherë

Gjetje 43: Veprimet në kartelat e pasurive për zbatimin e vendimit të Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/Zyra Rajonale Gjirokastër, nr. 57, datë 01.04.2009 nuk janë të rregullta e të sakta dhe janë kryer pa urdhër të regjistruesit përkatësisht për ndarjen dhe bashkimin e pasurive,

në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimit metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”(Trajtuar më hollësisht në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 54: Nga ZVRPP Gjirokastrë të merren masa për mbylljen e kartelave të pasurisë nr. 3127, vol. 20, fq. 39, zk. 2392, nr. 3130, vol. 20, fq. 42, zk. 2392, nr. 3055, vol 19, fq. 217, zk. 2392, me sip. 1067 m² me firmë dhe vulë të regjistruesit si dhe hapjen e kartelës së re përkatësisht për sipërfaqen 1429 m² në pronësi shtet ngelur nga pasuria nr. 3130, vol. 20, fq. 42, zk. 2392 me sip. 1772 m² dhe dy kartela të reja njëra me sipërfaqen 1018 m² në pronësi të M.G. dhe njëra për sipërfaqen e mbetur **prej 49 m²** nga pasuria mëmë 3055, vol 19, fq. 217, zk. 2392, me sip. 1067 m², e cila duhet të veçohet në shtet në përputhje me Udhëzimit metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Menjëherë

Gjetje 44: Në 4 raste ka mangësi në dokumentacionin e përdorur për regjistrimin e pasurive me leje legalizimi për pasuritë nr. 67/72, vol. 4, fq. 183, zk. 3701, 83/62, vol. 23, fq. 180, zk. 2392, nr. 3663, vol. 22, fq. 111, zk. 2392 dhe nr. 3665, vol. 22, fq. 109, zk. 2392, pasi mungon formulari i pagesës së parcelës ndërtimore, ortofoto dixhitale, HTR e përditësuar në kundërshtim me VKM nr. 258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara” pika 11.1 - Dorëzimi i dokumentacionit përkatës të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, në ZVRPP dhe Udhëzimin nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006; ”për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”(Trajtuar më hollësisht në faqe 114-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 55: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë, të merren masat për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor mbi pasuritë:

- nr. 67/72, vol. 4, fq. 183, zk. 3701; nr. 83/62, vol. 23, fq. 180, zk. 239; nr. 3663, vol. 22, fq. 111, zk. 2392; nr. 3665, vol. 22, fq. 109, zk. 2392.

Menjëherë

Gjetje 45: Në 2 raste ka mangësi në dokumentacionin e dorëzuar për regjistrimin e lejeve të ndërtimit në pasuritë nr. 34/29, vol. 3, fq. 188, zk. 3480-Sofratik dhe nr. 70/76, vol. 7, fq. 46, zk. 3701, si dhe nuk është rregulluar marrëdhënia e pasurisë me truallin, veprime këto në kundërshtim me Ligjin 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, neni 48, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Rregulloren nr. 184, datë 08. 04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Kreu IV-Regjistrimi fillestarë i një pasurie të paluajtshme, pika 12, Udhëzim nr. 3, datë 03.10.2012, Kreu IV- Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja, pika 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.6. (Trajtuar më hollësisht në faqe 78-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 56: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë, të merren masat për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasuritë nr. 34/29, vol. 3, fq. 188, zk. 3480-Sofratik dhe nr. 70/76, vol.7, fq. 46, zk. 3701, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dokumentimin e marrëdhënies së truallit me objektin ndërtesë. Gjithashtu nga ZVRPP duhet të aplikohet kamat vonesa në momentin e regjistrimit të kontratës shitblerje trualli nr. 1182 Rep, Nr. 694 Kol, datë 25.05.1992, për pasurinë nr. 34/29, vol. 3, fq. 188, zk. 3480-Sofratik, e cila administrohet në dosje por nuk është regjistruar.

Menjëherë

Gjetje 46: ZVRPP Gjirokastër në 3 rastet e referencave nr. 12940, 12831 dhe 12859 ka regjistruar VKKP dhe nuk rezulton të jenë vulosur dhe firmosur KPP nga ish-Regjistruesi, në 2 raste nuk ka procesverbal të dorëzimit të pronës veprim në papajtueshmëri me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme” dhe me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe me pikën 9.4, të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 *(Trajtuar më hollësisht në faqe 16-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandimi 57: ZVRPP Gjirokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit në 3 rastet e referencave nr. 12940, 12831, 12859 sipas **pasqyrës nr. 1** bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi bazuar në pikën “1”, neni 5, pikën “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara.

Brenda muajt Qershor 2016

Gjetje 47: ZVRPP Gjirokastër në 24 raste AMTP të audituara në 7 raste ka bërë regjistrime dhe nuk është veçuar pasuria shtet për sipërfaqen prej **1458 m²** dhe në dy raste janë kryer dhe transaksione, veprim në papajtueshmëri me germën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”. Nuk ka urdhër të regjistruarit për ndarje pasurie dhe KPP nuk janë vulosur nga ish- regjistruesi, në papajtueshmëri me nenin 34, të ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” *(Trajtuar në faqet 39-40 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi)*.

Rekomandimi 58 : Nga ZVRPP Gjirokastër të merren masa për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit për pasuritë sipas **pasqyrës nr. 2** bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi sipas numrave 4, 6, 10, 13, 14, dhe 18 deri në kryerjen e veprimeve për veçimin e pasurisë shtet në bazë të pikës 1, neni 5, pikës 1, nei 49 dhe nenit 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, si dhe të nxirret urdhër në çdo rast të ndarjes së pasurisë nga regjistruesi, zona Kadastrale 1799 Rurale Glinë.

Brenda muajt Qershor 2016

Gjetje 48: Regjistrimi i trojeve dhe shtëpive me 0001, në zonat urbane të fshatit në zbatim të VKM Nr. 432 datë 14.08.1995, është bazuar në një listë dërguar nga Komuna për fshatin Glinë pa nënshkrimin e Kryetarit të Komunës dhe Kryeplakun e fshatit Glinë, pa dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Auditimi i dokumentacionit rezulton të jenë regjistruar sipërfaqe më shumë se norma **750 m²** në papajtueshmëri me nenin 24/a të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 i ndryshuar mbasi duhet të ishte refuzuar regjistrimi dhe dhënia e certifikatës së pronësisë *(Trajtuar në faqet 39-40 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi)*.

Rekomandimi 59 : ZVRPP të marrë masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit për 9 pasuri evidentuar në **pasqyrën nr 3** bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi përkatësisht me nr. rendor 4, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18, bazuar në pikën 1, neni 5, pikën 1, neni 49 dhe nenin 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 zona Urbane Glinë.

Brenda muajt Qershor 2016

Gjetje 49: Gjatë regjistrimit të objekteve me leje ndërtimi Pallate dhe Banesa nuk është arkëtuar detyrimi për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta dhe tarifa shërbimit R-11 për **22 subjekte** me një **vlerë prej 2,560,300 lekë**, sipas **pasqyrës 4**, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa”, “pika 2”. Regjistrimi i lejeve të ndërtimit është bërë bazuar në kontratat e shitjes nga Bashkia për sipërfaqen prej 4527 m² duke vepruar në kundërshtim me ligjin për shitblerjen e trojeve 7980, datë 27.07.1995 dhe me VKM nr. 364, datë 05.10.1991, pika 1, si dhe me mangësi në dokumentacion në kundërshtim me pikën 5, të udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme

dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”(Trajtuar në faqet 68-78 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandimi 60: Nga ZVRPP Gjirrokastër të merren masa për nxjerrjen e urdhrave të kufizimit për subjektet evidentuar në pasqyrën nr. 4, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor dhe arkëtimit e detyrimit prej 2, 560, 300 lekë, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për shkeljet e konstatuara.

Brenda muajt Qershor 2016

Gjetje 50: Nga auditimi i KPP sipas referencën 005 rezulton se nga bashkimi pasurive shtet rezulton një sipërfaqe prej 21950 m² truall dhe 3200 m² ndërtim i fabrikës ujit G. ndërsa vijuar për regjistrim në v. 5, faqe 145 rezulton të jetë regjistruar truall 25719 m² dhe ndërtim 13133 m² me një diferencë sipërfaqe 3769 m² truall dhe ndërtim 9993 m².

Sipas dokumentacionit në dosje të dhënies së lejes së ndërtimit, ndërtimi rezulton të jetë 7837 m² dhe regjistruar 13133 m² ose 5296 m² ndërtim më tepër pa dokumentacionin e duhur ligjor, për të cilat mban përgjegjësi ish regjistruari H.M. dhe hartografi I.B. Sikurse evidentohet rezulton të jetë Blerë truall nga Bashkia sipas kontratave nr. KSHB nr. 660/134, date 22.09.2000, nr. 158/38, date 31.03.2000 dhe KSHB nr. 157/37, date 31.03.2000 KSHB me shoqërinë A.G., në kundërshtim me ligjin 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve” dhe me VKM nr. 364, datë 05.10.1991, pika 1, mbasi trualli vlerësohej vetëm për dhënie me qira dhe jo për shitje dhe vetëm për rastet e privatizimit të objekteve dhe jo për dhënien e lejeve të ndërtimit. (Trajtuar në faqet 68-78 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandim 61: ZVRPP Gjirrokastër të marrë masa për kërkimin e informacionit lidhur me përcaktimin e statusit ligjor të Fabrikës Ujit G. dhe mbi bazën e njohjes së këtij statusi të njoftojë KLSH-në, i cili nga ana e vetë pasi ta vlerësojë atë, rezervon të drejtën e dhënies së një rekomandimi lidhur me nxjerrjen e urdhrit të kufizimit për trojet e regjistruara në pronësi të shoqërisë A. shpk si troje të shitura pa qenë të regjistruara në pronësi të Komunës dhe kundërshtim me ligjin 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve” dhe me VKM nr. 364, datë 05.10.1991, pika 1, si dhe për pasaktësitë evidentuar në këtë projekt në lidhje me sipërfaqen e regjistruar me diferencë më tepër prej 3769 m² truall dhe diferencë sipërfaqe ndërtimi regjistruar më tepër për 5296 m² për objektin fabrika e Ujit G. pa dokumentacionin e duhur ligjor nga privatizimi dhe lejet e ndërtimit, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për shkeljet e konstatuara.

Brenda muajt Qershor 2016

Gjetje 51: Në 12 raste sipas pasqyrës nr. 8, pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi janë ndarë dhe janë regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme duke lëshuar certifikata pronësi pa urdhër të Regjistruarit dhe duke mos verifikuar elementët e përmbajtjes së Aktit Administrativ dhe të kontratës noteriale me VKM mbi të cilëve janë miratuar parcelat e ndërtimeve informale, në zbatim të Udhëzimit të KM nr. 2, date 12.09.2012, në papajtueshmëri me pikën 12 Kreu IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (Trajtuar në faqet 111-113 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandimi 62: ZVRPP Gjirrokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave në rastet e ndarjes së pasurive dhe verifikimin e elementëve të formës e përmbajtjes së një akti administrativ në zbatim të Udhëzimit KM nr. 2, date 12.09.2012.

Brenda muajt Qershor 2016

Gjetje 52: ZVRPP Gjirrokastër në të gjitha rastet, KPP në ZK 8541, ZK 1799 Glinë janë pa vulën e ZVRPP Gjirrokastër dhe pa nënshkrimin e Regjistruarit duke lëshuar certifikatë dhe vërtetime pronësie, veprim në papajtueshmëri me pikën 23.3, Kreu IV dhe pika 1, Kreu i VI, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar

pikën 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999, “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”(Trajtuar në faqet 111-113 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandim 63: Regjistruesi i ZVRPP Gjirrokastër të marrë masa, të vendosi datë përfundimtare në kartelat e pasurisë së paluajtshme.

Në vazhdimësi

Gjetje 53: Sipas referencës nr. 9371, regjistruar truall 210 m² dhe ndërtim 124 m² me nenin 24/b sipas vendimit të gjykatës nr. 54/245 datë 16.01.1997, në kundërshtim me Udhëzimin KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 3, shkronja a, b, dhe pika 6 shkronja a, c, ç, mbasi nuk ka dokumentacion ligjor pronësie të regjistruar në regjistrat hipotekor dhe vendimi i gjykatës është me vërtetim fakti juridik, veprim në papajtueshmëri me pikën 12 Kreu IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999. Me Referencë nr. 9187 regjistruar truall 200 m² me KSHB nr. 1707/937, datë 17.11.1992 me shitës seksioni i Financës në kundërshtim me VKM nr. 364, datë 05.10.1991 në pikën 1, ndërsa shitja e trojeve nuk rezulton të jetë përcaktuar me ligj, përcaktuar me ligj më vonë me nr. 7980, datë 27.07.1995 duke specifikuar rastet. Me referencë nr. 12789, regjistruar truall 132 m² dhe ndërtim 108 m² në kundërshtim me neni 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, i ndryshuar dhe urdhrin nr. 37, datë 06.06.2000 “Mbi zbatimin e nenit 24/b, të ligjit 7843, datë 13.07.1994”(Trajtuar në faqet 149-152 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandim 64: ZVRPP Gjirrokastër të marrë masa për kufizimin e pasurive sipas referencave 9371, 9187 dhe 12789 deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara.

Brenda muajit Qershor

Gjetja 54: Në kuptim të nenit 193 të kodit civil regjistrimi për truall 756 m², dhe ndërtim 129.3 m² shtëpi është bërë pa pasur dokumentacion të ligjshëm pronësie dhe është regjistruar sipas kontratës së dhurimit -Kontratë dhurimi nr. 76/60 datë 09.11.1982 pa dëshmi të trashëgimisë ligjore, veprim në papajtueshmëri me pikën 14. a, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me nenin 24/b të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, i ndryshuar dhe urdhrin nr. 37, datë 06.06.2000 “Mbi zbatimin e nenit 24/b, të ligjit 7843, datë 13.07.1994”(Trajtuar në faqet 149-152 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandim 65: ZVRPP Gjirrokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhrin të kufizimit për pasurinë 16/33 në pronësi të G.N. regjistruar në kundërshtim me nenin 24/b të ligjit 7843, datë 13.07.1994 i ndryshuar deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara.

Brenda muajit Qershor

Gjetja 55: ZVRPP Gjirrokastër në kundërshtim me ligjin nr 33/2012, datë 21.03.2012 nuk ka regjistruar VKKP nr. 134, datë 13.03.2008, duke e refuzuar regjistrimin sipas urdhrin **nr. 32, datë 28.12.2011 plotësuar në tejkallim të kompetencave** duke refuzuar regjistrimin e titullit të pronësisë sipas vendimit të AKKP nr. 134, datë 13.03.2008 pa argumente ligjor, i cili në pjesën vendimore i njeh K/Gjyshatës Bektashiane **420000 m² truall, i kthen 273558 m² dhe i kompenzon 146 442 m²**, në vijim nga ish-Kryeregjistruesi A.Q. është refuzuar regjistrimi sipas urdhrin **nr. 61, datë 25.01.2012** në tejkallim të kompetencave dhe në shkelje dhe të ligjit nr. 10058, datë 22.01.2009 neni 3 për garantimin e realizimit të drejtave të sanksionuara me kushtetutë dhe ligj, në shkelje të KREUT V-të “Çështjet e pronësisë” neni 22 pika 2 ku Shteti duhet ti kthejë e kompensojë Kryegjyshatës të gjitha pronat (Trajtuar në faqet 156-163 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandimi 66: ZVRPP Gjirrokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhrin për kufizimin e regjistrimeve të pasurive të ndodhura brenda pasurisë së përcaktuar për kthim në pronësi të Kryegjyshatës sipas vendimit të KKP nr. 134, datë 13.03.2008 në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të

Paluajtshme” dhe të zbatoje urdhrin për regjistrimin në pronësi të Kryegjyshitës të pasurive të kthyerë në sipërfaqen prej **271631 m²** të llojit troje të lira evidentuar në pasqyrën 11, dhe përcaktuar në hartën e punës së ZVRPP Gjrokastër administruar për këtë qëllim si troje të lira.

Brenda muajit Qershor

Gjetje 56: Nga verifikimi i 4 kërkesë-ankesave drejtuar për verifikim Kontrollit të Lartë të Shtetit, u konstatuan disa mangësi e shkelje si dhënie sipërfaqe më tepër me HTR mbi 300 m² z. J. R., regjistrim truall në favor të Q.M. sipas kontratës shitjes nga Këshilli i Qarkut i cili nuk është pronar pasi nuk ka të regjistruar sipërfaqen prej 1000 m² e cila gjendet brenda pasurisë 6475 m² përfituar nga K.M., ndërsa në dy raste të ankimit nga z. K. M. dhe z.S. A. nga verifikimi rezultoi se pretendimet e tyre nuk përbëjnë objekt të punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe duhet të drejtohen Gjykatës (*Trajtuar në faqet 178-180 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

Rekomandimi 67: Për pasurinë e përfituar më tepër nga J.R. me HTR dhe kontratë shitje pa dokumentacionin e duhur ligjor ZVRPP Gjrokastër të marrë masa për nxjerrjen e urdhrin të Kufizimit duke njoftuar palët dhe të kërkojë Komunës Dropull verifikimin e sipërfaqes përfituar më tepër duke përcaktuar pozicionin dhe sipërfaqen që duhet të përfitonte, ndërsa për sipërfaqen prej 1000 m² shitur nga Këshilli i Qarkut të merret masa për nxjerrjen e urdhrin të Kufizimit dhe të njoftohen palët, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Me dërgimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbas shqyrtimit përfundimtar të ankësive të kthehet përgjigje për ankuesit sipas konstatimit.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbarimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **20,680,521 lekë**, si më poshtë:

Rekomandim 1: ZVRPP Gjrokastër, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Gjrokastër për masat e marra (rekomanduar masa org. nr.12 më sipër), urdhrin e fshirjes së regjistrimit për **9 kontratat** (kontratat nr. 2994 me 2 pasuri, nr. 1211 me 2 pasuri, nr. 1345 me 1 pasuri, nr. 1399 me 3 pasuri përkatësisht sipas tabelës I,II,III,IV,V,VI,VII, IX,X) dhe të ndiqen hapat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **432,300 lekë** nga e cila **300,000 lekë** kamatë vonesa viti 2013 për ZVRPP dhe për Bashkinë Gjrokastër vlera 132,300 lekë qera dhe tatim qeraje për kontratat e v.2013-2014 ndaj personave qiramarrës pasqyruar në tabelën “**Përmbledhëse PPL Shtetërore Publike sipas llojit për regjistrim Kontrata përdorimi e qiraje dhe dëmet ekonomike të pa aplikuar nga ZVRPP Gjrokastër v. 2013, 2014 dhe 2015**”.

Menjëherë

Rekomandim 2: ZVRPP Gjrokastër, Regjistruesi të njoftojë Bashkinë Gjrokastër për masat e marra (rekomanduar masa org. nr.15 më sipër), me urdhrin e mbylljes së KPP nr. 6/95, v. 28, f. 206, zk. 8541 e llojit truall me sipërfaqen 585,9 m², mbi të cilën ngrihet ndërtesa 2kt në sipërfaqe ndërtimi 222 m², të çeljes KPP e re nr., v. fq. Zk 8541 për llojin truall me sipërfaqe 585,9 m², regjistrimin në pronësi “Shtet”, në juridiksion të pronësi të Bashkisë e cila të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e dëmit vendosur si barrë kufizuese në vlerën **16,048,170 lekë** (15,467,670 lekë qira e munguar nga përdorimi i jashtëligjshëm i truallit, vlera 572,400 lekë për

shpronësimin e marrë p[ar]a titull pronësie), përkatësisht ndaj Bashkisë Gjirokastrë vlerën **15,467,670 lekë** si Qira e munguar nga përdorimi i jashtëligjshëm e pa titull pronësie të truallit prej 585,9 m² dhe ndaj Buxhetit të shtetit për vlerën **572,400 lekë** e shpronësimit të përfituar pa drejtësisht e pa titull pronësie të truallit në sipërfaqen 143,1 m².

Menjëherë

Gjetje: ZVRPP Gjirokastrë për 5 raste, të marrë masat për arkëtimin e **vlerës prej 319,944 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, e përbërë nga:

- Vlera **prej 14,000 lekë** për mungesë aplikimi në praktikën me referencë 0295, në ZK nr. 2392 Lazarat, për shërbimin e regjistrimit të pasurive të regjistruara dhe të certifikuara me nr. 10/42, volum 2, faqe 71, nr. 25/67, volum 4, faqe 211, nr. 26/109, volum 5, faqe 72 dhe nr. 83/40, volum 8, faqe 121, bazuar në tarifat e pagesave që duhet të paguante.

- Vlera **prej 11,000 lekë** për shmangie të arkëtimin të detyrimit për regjistrim “banese” me sipërfaqe 83 m² në volum 7, faqe 87, pasuria nr. 10/9 në favor të subjektit S.B. për shërbimin e kërkuar vërtetim hipotekor, HTR dhe KPP, në ZK nr. 8542 qytet Gjirokastrë, sipas referencë nr. 02360.

- Vlera **prej 192,430 lekë** për mos regjistrim të dy dëshmi trashëgimive nr. 763, datë 02.05.2008 dhe nr. s’ka, datë 30.06.2008 që duhet të paguan tarifën e shërbimit së bashku me kamat vonesën, nga B.B. i cili ka kërkuar shërbimi i lëshimit të certifikatës së pronësisë, HTR dhe KKP për pasurinë nr. 17/37, në volum 6, faqe 122, në ZK nr. 8542 Gjirokastrë, me referencë nr. 02077.

- Vlera **prej 21,314 lekë** për diferencë të papaguar nga subjekti S.B., për pasurinë nr. 2/213 dhe regjistrimin e pronës sipas nenit 24/b, në volum 7, faqe 187, në ZK nr. 8542 qytet Gjirokastrë në, sipas dokumentacionit që ndodhet në referencë nr. 02677.

- Vlera **prej 81,200 lekë** për mos regjistrim të dëshmi trashëgimisë nr. 2155, datë 11.12.2009, pra nuk është paguar vlefata e kamat vonesave në regjistrim që llogariten për **1160 ditë vonesë**, pasuria nr. 2067 regjistruar në volum 2, faqe 85, në ZK nr. 2781, fshati Nepravishtë Gjirokastrë sipas dokumentacionit që ndodhet në referencë nr. 0037, veprime në papajtueshmëri me nenin 39, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe VKM nr. 292, datë 24.04.2003, “Për caktimin e tarifave në ZVRPP”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 36-39, 126-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 3: Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastrë, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **320,854 lekë** ndarë: **14,000 lekë** për pasuritë nr. 10/42, volum 2, faqe 71, nr. 25/67, volum 4, faqe 211, nr. 26/109, volum 5, faqe 72 dhe nr. 83/40, volum 8, faqe 121, bashkëlidhur referencës 0295, në ZK nr. 2392 Lazarat; **11,000 lekë**, për pasurinë nr. 10/9, volum 7, faqe 87, në ZK nr. 8542 Gjirokastrë, sipas referencë nr. 02360; **192,430 lekë**, për pasurinë nr. 17/37, volum 6, faqe 222, në ZK nr. 8542 Gjirokastrë, sipas referencë nr. 02077; **21,314 lekë**, për pasurinë nr. 2/213, volum 7, faqe 187, në ZK nr. 8542 Gjirokastrë, sipas referencë nr. 02677 dhe **81,200 lekë**, për pasurinë nr. 2067, volum 2, faqe 85, në ZK nr. 2781, fshati Nepravishtë Gjirokastrë, sipas referencë nr. 0037, deri në pagesën e plotë të vlerave.

Brenda muajit Qershor 2016

Gjetje: - Regjistrimi në të njëjtën kartelë i pasurisë së përfituar nga lista 0001 nuk është i rregullt, çelur KPP për pasurinë nr. 3032, vol. 19, fq 195, pasi ka sjellë si pasojë mos kërkimin nga ZVRPP e likuidimit të vlerës ndërtimore të objektit **20,999 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik**, pa përfshirë këtu interesat e mos likuidimit të kësaj shume që prej datës 27.09.1992. - Nga ana e ZVRPP nuk është llogaritur e ndalur kamat vonesa për regjistrim të vonuar të kontratës së shitjes Nr. 1346 Rep, Nr. 707 Kol, datë 27.09.1992, për pasurinë nr. 3032, vol. 19, fq. 195, zk. 2392, në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 39- “Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim” duke **i shkaktuar buxhetit të**

shtetit një dëm ekonomik në vlerën 300,000 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim 4: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për kufizimin e pasurisë nr. 3032, vol. 19, fq. 195, zk. 2392 deri në arkëtimin e vlerave të konstatuara si dëm ekonomik më sipër në përputhje me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60. Gjithashtu të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e **shumës 320,999 lekë** shkaktuar nga kamat vonesa dhe mos kërkimi i likuidimit të vlerës ndërtimore.

Menjëherë

2. Gjetje: Në **4 raste** ka rezultuar se me pasuritë nr. 92/13, vol. 6, fq. 63, zk. 3907, e llojit arë, me sip. 17056 m² dhe nr. 92/2, vol. 6, fq. 52, zk. 3907, me sip. 2775 m², e llojit arë, nr. 101/14, vol. 6, fq. 238, zk. 3907, me sip. 620 m² dhe pasuria nr. 98/2, vol. 6, fq. 91, zk. 3907, e llojit arë, me sip. 1227 m², të regjistruara fillimisht me AMTP, me sipërfaqe më të vogël se ajo e përcaktuar më pas në Librin e Ngastrave Korrik 2001, **pa u veçuar më parë në shtet sipërfaqja e tepërt 418 m² në total**, janë kryer transaksione duke shitur e tjetërsuar pasurinë shtet tek personat privatë, si dhe duke i shkaktuar shtetit **një dëm ekonomik në vlerë 128,744 lekë** (llogaritur sipas çmimit të tregut në bazë të VKM nr.), veprime këto në kundërshtim me sipërfaqen e përcaktuar në AMTP, ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” si dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzim metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”. Gjithashtu në dosje nuk administrohen formularët dhe mandatet për llogaritjen e vlerës së tatimit të kalimit të pronësisë për 4 kontrata shitje, duke rezultuar një vlerë **15,000 lekë** e mos paguar e cila përbën dëm ekonomik. (Trajtuar më hollësisht në faqe 47-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 69: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **128,744 lekë** për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 418 m², nga personat përgjegjës si më poshtë:

- **z. L.Xh.**, me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe **z. A.P.** me detyrë ish-regjistrues për vlerën **52,360 lekë**.

- **z. K. K.** me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe **z. J.R.** me detyrë ish-regjistrues për vlerën **34,188 lekë**,

- **z. I.B.** me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe **z. S.J.** me detyrë ish-regjistrues për vlerën **20,636 lekë**,

- **z. Th. C.** me detyrë ish-Specialist Hartograf dhe **z. N.D.** me detyrë ish-regjistrues për vlerën **21,560 lekë**.

Menjëherë

Rekomandim 70: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **15,000 lekë** e ardhur nga shmangia e pagesës së taksës për kalimin e pronësisë, si dhe të mos kryej asnjë veprim mbi pasuritë përkatëse deri në dorëzimin e dokumentit që vërteton pagesën.

Menjëherë

Gjetje: Në një rast ka rezultuar se me pasurinë nr. 30/3, vol 3, fq. 136, zk. 3701-Valare, me sipërfaqe 6600 m², e llojit arë, regjistruar fillimisht me AMTP, me sipërfaqe më të vogël se ajo e përcaktuar më pas në Librin e Ngastrave Qershor 1997, **pa u veçuar më parë në shtet sipërfaqja e tepërt 10 m²**, janë kryer transaksione duke shitur e tjetërsuar pasurinë shtet tek personat privatë, si dhe duke i shkaktuar shtetit **një dëm ekonomik në vlerë 100,000 lekë**, veprime këto në kundërshtim me sipërfaqen e përcaktuar në AMTP, ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” si dhe Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzim metodik Nr. 76 Prot, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme” (Trajtuar më hollësisht në faqe 47-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim 5: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **100,000 lekë** për shitjen e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 10 m², nga personat përgjegjës si më poshtë:

- **z. L.Xh.**, me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën **33,333 lekë**
- **z. D.P.** me detyrë ish-Specialist Jurist për vlerën **33,333 lekë**
- **z. K.M.** me detyrë ish-Regjistruer për vlerën **33,333 lekë**.

Menjëherë

Gjetje: Nga verifikimi i rivlerësimit të pasurisë nr. 30/3, vol 3, fq. 136, zk. 3701-Valare sipas Ref. 0417, rezultoi se nga subjekti Devoll Gjollëshi nuk është paguar tatimi **për regjistrimin e kontratës së shitjes në vlerën 30,954 lekë** (10 % i diferencës të çmimit të shitjes me vlerën e rivlerësimit) **vlerë e cila përbën dëm ekonomik**, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 11- Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, dhe Udhëzimin nr. 9, datë 26.02.2008, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 21, datë 26.02.2009 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme” (Trajtuar më hollësisht në faqe 78-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim 6 Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **30,954 lekë** e ardhur nga shmangia e pagesës së taksës për kalimin e pronësisë, si dhe të vendosë kufizimin mbi pasurinë nr. 30/3, vol 3, fq. 136, zk. 3701-Valare deri në dorëzimin e dokumentit që vërteton pagesën.

Menjëherë

Gjetje: Nuk është llogaritur e ndalur kamat vonesa si dhe tarifa për regjistrimin e Vendimit të Gjykatës nr. 56, datë 21.01.1992 për pasurinë nr. 108/16, vol. 2, fq 61, zk. 3535, Suhe, në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 39- Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim, duke i **shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 303,500 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqe 121-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim 7: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **303,500 lekë** e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës si dhe tarifës për regjistrimin e Vendimit të Gjykatës, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit mbi pasurinë nr. 108/16, vol. 2, fq 61, zk. 3535, Suhe në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në likuidimin e vlerës.

Menjëherë

Gjetje: Nuk është llogaritur e ndalur kamat vonesa për regjistrimin e vonuar nga data e njoftimit të vendimit për shqyrtimin e ankimit nga AKKP-ja 14.02.2012 deri në datë e aplikimit për regjistrimin e vendimit të KKKP-së, pra 14.05.2012, në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 39- Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim, në vlerë **60,000 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**. (Trajtuar më hollësisht në faqe 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 8: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **60,000 lekë** e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e Vendimit të KKKP-së, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit mbi pasuritë:

- nr. 3684, vol. 22, fq. 96, zk. 2392,
- nr. 3055, vol 19, fq. 217, zk. 2392,

në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në likuidimin e vlerës.

Menjëherë

Gjetje: Në një rast për praktikën e pasurisë 253/31, vol. 5, fq.78 dhe nr. 253/32, vol. 5, fq. 79, zk. 3421, në pronësi të T. dhe S. A., nga verifikimi i marrëdhënies së pasurisë truall me pasurinë

ndërtim pa leje, rezultoi se është shitur dhe tjetërsuar sipërfaqja prej 321 m², e cila duhet të regjistrohej në pronësi shtet, me pasojë dëmin ekonomik në vlerë **52,000 lekë**, pasi sipërfaqja sipas AMTP është më e vogël se ajo e përcaktuar në LN, matjet faktike, veprime këto në kundërshtim me sipërfaqen e përcaktuar në AMTP, ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” si dhe Ligjin nr 7843, 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” (Trajtuar më hollësisht në faqe 114-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 9: Nga ana e ZVRPP Gjirokastër të merren masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **52,000 lekë** ardhur nga shitja e pronës shtetërore në sipërfaqe totale 321 m², nga personat përgjegjës si më poshtë:

- **z. L.Xh.**, me detyrë ish-Specialist Hartograf për vlerën **26,000 lekë**

- **z. N.D.**, me detyrë ish-Regjistrues për vlerën **26,000 lekë**.

Menjëherë

Gjetje: Nuk është llogaritur e ndalur kamat vonesa për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit nr. 3, datë 12.11.2013, për pasurinë nr. 70/76, vol. 7, fq. 46, zk. 3701 dhe për këtë arsye është përdorur shkresa e Komunës Lunxhëri nr. 72, datë 25.02.2015, për të përcjellë dokumentacionin për regjistrim, ndërkohë që afati i fundit për përcjelljen e dokumentacionit për regjistrim, ka qenë brenda 30 ditëve, pra data 12.12.2013. Mos aplikimi i kamat vonesës vjen në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 39- Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim duke i shkaktuar buxhetit shtetit një dëm **ekonomik në vlerë 300,000 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqe 78-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 10: Nga Regjistruesi i ZVRPP Gjirokastër, të merren masat për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **300,000 lekë** e ardhur nga mos llogaritja e kamat vonesës për regjistrimin e vonuar të lejes së përdorimit nr. 3, datë 12.11.2013, si dhe nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, mbi pasurinë nr. 70/76, vol. 7, fq. 46, zk. 3701 deri në likuidimin e vlerës.

Menjëherë

Gjetje: Nga ZVRPP Gjirokastër në **22 raste**, për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme nuk është arkëtuar tarifa e shërbimit R-11 dhe tarifa e përcaktuar për hapësirat e përbashkëta të paregjistruara në vlerën prej **2.560.000 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, veprim në papajtueshmëri me nenin 71, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe VKM nr. 713, datë 20.10.2011 “Për caktimin e tarifave të shërbimit në ZVRPP”, të ndryshuar dhe Urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 3842, datë 08.04.2014 “Për dërgim buletini” dhe në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme neni 50, “**Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa**”, “pika 2.

Rekomandim 11: ZVRPP Gjirokastër të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë rrugë ligjore arkëtimin e detyrimit prej **2,560,300 lekë**, sipas pasqyrës 4 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi (trajtuar në faqet 68-78 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi)

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **ti kërkojmë Kryeregjistruesit ZQRPP**

Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Mosngritje në detyrë për 2 vjet”, për këta punonjës:

1. **Për z.L.B.**, me detyrë hartograf, për shkeljet trajtuar në *faqet procesverbali nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 5, datë 16.02.2016, nr. 6, datë 16.02.2016, nr. 10, datë 23.02.2016, nr. 18, datë 01.3.2016, nr. 25, datë 01.03.2016 nr. 32, datë 01.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2. **Për z. B.B.**, me detyrë ish jurist zv. Regjistruer, për shkeljet trajtuar në *procesverbalet nr. 3, datë 02.02.2016, nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 6, datë 16.02.2016, nr. 10, datë 23.02.2016, nr. 13, datë 26.02.2016, nr. 15, datë 29.02.2016, nr. 8, datë 01.03.2016, nr. 18, datë 01.3.2016, nr. 20, datë 01.3.2016, nr. 22, datë 01.03.2016, nr. 25, datë 01.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3. **Për z. F.H.**, me detyrë Regjistruer aktual për shkeljet trajtuar në *akt verifikimet nr. 1, datë 11.01.2016, nr. 2, datë 24.02.2016, procesverbali nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 5, datë 16.02.2016, nr. 18, datë 01.3.2016, dhe procesverbalet nr. 25, datë 01.03.2016, nr. 26, datë 04.03.2016, nr. 30, datë 10.03.2016, nr. 32, datë 01.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4. **Për z. E.B.**, me detyrë hartograf, për shkeljet trajtuar në *procesverbali nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 5, datë 16.02.2016, në procesverbalin nr. 6, datë 16.02.2016, nr. 25, datë 01.03.2016, nr. 26, datë 04.3.2016, nr. 27, datë 08.3.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

5. **Për z. B.K.**, me detyrë specialist hartograf, për shkeljet trajtuar në *procesverbalin nr. 5, datë 16.02.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

6. **Për z. N.N.**, me detyrë jurist, për shkeljet trajtuar në *procesverbalin nr. 18, datë 01.3.2016, nr. 25, datë 01.03.2016 në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

I. Për ish drejtuesit dhe ish punonjësit nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga “vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, përkatësisht për:

1. **Për z. H.M.**, me detyrë ish Regjistruer, në vitet 1999-2003, për shkeljet trajtuar në *procesverbali nr. 1, datë 29.01.2016, nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, nr. 35, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2. **Për z. S.J.**, me detyrë ish-Regjistruer në vitet 2005-2006, për shkeljet trajtuar në *procesverbali, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 28, datë 08.3.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 10, datë 23.02.2016, nr. 32, datë 01.03.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, nr. 35, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3. **Për z. F.K.** me detyrë ish-Regjistruer në vitet 2007-, për shkeljet trajtuar në *procesverbali nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4. Për nj. Dh.P. me detyrë ish Regjistruese, për shkeljet trajtuar në procesverballi nr. 29, datë 09.3.2016, ne faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Për z. N.D., me detyrë ish-Regjistrues, V.2008-2009 për shkeljet trajtuar në procesverballi nr. 4, datë 9.02.2016, procesverballin nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, nr. 32, datë 01.03.2016, faqet 35-68, 270-273, 287-293, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. Për z. J.R., me detyrë ish Regjistrues, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 10, datë 23.02.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7. Për z. Dh.K., me detyrë ish regjistrues vitet 2011-2013, për shkeljet trajtuar në akt verifikimet nr. 1, datë 11.01.2016, nr.2, datë 24.02.2016, nr. 9, datë 11.03.2016, etj, si në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8. Për z. K.J., me detyrë ish-specialist, ish Regjistrues, për shkeljet trajtuar në procesverballi nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 5, datë 16.02.2016, nr. 6, datë 16.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, 68-83 ne faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9. Për z. A.P., me detyrë ish Regjistrues, v. 2010, aktualisht specialist në Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR) Gjirokastrë, për shkeljet trajtuar në procesverballin nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 9, datë 23.2.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, sipas referencën nr. 9041, datë 8.2.2011, nr. 28, datë 08.3.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10. Për z.T.T., me detyrë ish-hartograf në vitin 2005, për regjistrimet sipas referencës nr. 4035, datë 13.01.2005, aplikimi nr. 48, (nr. 0116949) datë 13.01.2005, e çeljen KPP e pasurisë nr. 6/23, v. 15, f. 32 zk. 8541, lloji truall me sipërfaqe 729 m² ndodhur në lagjen “18 Shtatori; nr. 10, datë 23.02.2016, nr. 28, datë 08.3.2016, ne faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11. Për z.. B.G., me detyrë ish specialist vitet 2005-2006, për shkeljet trajtuar në procesverballin nr. 8, datë 18.2.2016, ne faqet 287-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12. Për z. I.B., me detyrë ish specialist prej vitet 2005-2006 për shkeljet trajtuar në procesverballin nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, nr. 35, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13. Për z. L.Xh. me detyrë ish-hartograf vitet 2006-2014 për shkeljet trajtuar në akt-verifikimin nr. 9, datë 11.03.2016 dhe procesverballin nr. 1, datë 29.01.2016, nr. 2, datë 6.11.2015, nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 5, datë 16.02.2016, nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 12, datë 25.02.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, nr. 32, datë 01.03.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

14. Për z. J.A., me detyrë ish specialist Jurist vitet 2010- 2013, për shkeljet trajtuar në akt-verifikimin nr. 9, datë 11.03.2016 dhe procesverballin nr. 1, datë 29.01.2016, nr. 2, datë 02.02.2016, nr. 3, datë 02.02.2016, nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 6, datë 16.02.2016, nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 9, datë 11.03.2016, nr. 10, datë 23.02.2016, nr. 13, datë 26.02.2016, nr. 14, datë 29.2.2016, nr. 15, datë 29.2.2016, nr. 19, datë 01.3.2016, nr. 20, datë 01.3.2016, nr. 21, datë 01.3.2016, nr. 22, datë 01.03.2016, nr. 23, datë 01.3.2016, pritës për regjistrimin sipas referencës

nr. 9198, datë 6.4.2012 për urdhrin kufizimi nr. 473, datë 30.7.2012, nr. 28, datë 08.3.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, nr. 31, datë 11.03.2016, nr. 32, datë 01.03.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, nr. 34, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

15. Për z. K.R., me detyrë ish hartograf vitet 2007-2012 aktualisht topograf në NJA ish-Komuna Cepo Bashkia Gjirokastrë), me cilësinë e mbajtjes shënimeve në KPP, për shkeljet trajtuar në *akt-verifikimi nr. 9, datë 11.03.2016 dhe procesverbali nr. 1, datë 29.01.2016, nr. 2, datë 02.02.2016, nr. 3, datë 02.02.2016, nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 6, datë 16.02.2016, nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 13, datë 26.02.2016, nr. 15, datë 29.02.2016, nr. 19, datë 01.03.2016, nr. 20, datë 01.03.2016, nr. 22, datë 01.03.2016, nr. 24, datë 01.03.2016, nr. 28, datë 08.3.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, nr. 34, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

16. Për z. K.K., me detyrë ish- topograf v. 2004-2006, për shkeljet trajtuar në *procesverbali nr. 1, datë 29.01.2016, procesverbali nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 7, datë 17.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 32, datë 01.03.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

18. Për z.G.Zh., me detyrë ish- jurist vitet 1999-2005, për shkeljet trajtuar në *procesverbali nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 10, datë 23.02.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

19. Për z. K.M., me detyrë ish Regjistrues, 11.11.2013 deri 24.10.2014, aktualisht Drejtor ALUIZN Gjirokastrë, për shkeljet trajtuar në *akt verifikimet nr. 1, datë 11.01.2016, nr. 2, datë 24.02.2016, nr. 9, datë 11.03.2016, dhe procesverbalet nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 5, datë 16.02.2016, nr. 13, datë 26.02.2016, nr. 25, datë 01.03.2016, nr. 26, datë 04.03.2016, nr. 27, datë 08.3.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

20. Për z. A.Zh., me detyrë ish hartograf,(aktualisht dale pension), për shkeljet trajtuar në *akt-verifikimin nr. 9, datë 11.03.2016 dhe procesverbalin nr. 3, datë 02.02.2016, nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 6, datë 16.02.2016, nr. 8, datë 18.2.2016, nr. 10, datë 23.02.2016, nr. 11, datë 25.2.2016, nr. 13, datë 26.2.2016, nr. 15, datë 29.2.2016, nr. 16, datë 01.03.2016, nr. 17, datë 01.03.2016, nr. 20, datë 01.3.2016, nr. 21, datë 01.3.2016, nr. 22, datë 01.3.2016, nr. 23, datë 01.3.2016, nr. 26, datë 04.03.2016, nr. 31, datë 11.03.2016, nr. 32, datë 01.03.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, nr. 34, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

21.Për z. D.P., me detyrë ish-jurist, v. 2009-2013, të për shkeljet trajtuar në *procesverbali nr. 4, datë 9.02.2016, nr. 13, datë 26.02.2016, nr. 16, datë 01.3.2016, nr. 29, datë 09.3.2016, nr. 33, datë 11.03.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

22. z. Th.C., me detyrë ish-Specialist, për shkeljet trajtuar në **procesverbalin nr. 7, datë 17.02.2016, në faqet të Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

Për punonjësit aktual dhe 22 punonjësit e larguar përcaktuar më sipër masat kërkohe:

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012 datë 21.3.2012“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 1, të UKM nr. 1, datë 31.07.2007 “Për proceduarat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe kapitullin e I, të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” dhe të

Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar e veprimeve të tjera, të pasurive të paluajtshme, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për ZVRPP Gjirokastrë.

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për: **F.H., Regjistrues i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, z. E.B. specialist hartograf dhe 3 ish-specialistët e ZVRPP Gjirokastrë z. K.J., z. A.ZH. dhe z.J.A,** të cilët në mospërmbyllje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të *përcaktimeve ligjore e nënligjore të bëra në Ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”* kanë konsumuar elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R